



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe
Sporte”**

ofruar nga

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asc.Dr. Robert Çitozi

PhD. Roven Elmazi

Korrik / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMARS Nr.416, Datë 29.07.2019.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr 73.datë 15.03.2022 i QSHA-së
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për here të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike, me 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Ofrohet në gjuhën shqipe.
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6-të
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 12 PAE / 10 PAK 2023-2024 15 PAE / 8 PAK 2024-2025 16 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 41 studentë 2023-2024 37 studentë 2024-2025 39 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë ka filluar aktivitetin e tij akademik bazuar në VKM Nr.5, datë 07.01.1992 mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar në vitin 1971. Universiteti i Korçës mban emrin zyrtar "Fan S. Noli", dhënë në vitin 1994, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Struktura Akademike e Universitetit "Fan.S.Noli", Korçë është organizuar me katër Njësi Kryesore, prej të cilave: katër fakultete (Fakulteti i Bujqësisë; Fakulteti i Ekonomisë; Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë; Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane).

Gjatë viteve, struktura akademike e UNIKO i është nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve, ndër të cilat spikasin ato që lidhen me fuqizimin e veprimtarisë së pavarur të departamenteve, forcimin e rolit koordinues në nivel njësie kryesore e IAL-je si dhe përmirësimin e administrimit dhe strukturën organizative të universitetit.

Një arritje në aspektin e hapjes së programeve të reja të studimit për këtë institucion ka qenë hapja me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.416, Datë 29.07.2019. "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte".

Programi studimit është hapur pranë Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë (FEF), Departamenti i "Edukimit". Ky program studimi funksionon në përputhje me Ligjin 80/2015 "Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, detyrimeve të procesit të Bolonjës dhe sfidave të garantimit të cilësisë në çdo hallkë e aktivitet të tij, misionin dhe vizionin e UNIKO.

Ky program studimi i konceptuar me një filozofi moderne krijon mundësi inter-disiplinariteti brenda fushës së formimit bazë dhe synon përgatitjen e specialistëve në fushën e aktivitetit fizik dhe sporteve duke mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike ose profesionale në mësuesi apo një nga drejtimet e fushës së sporteve.

Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të japë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike. Të kombinuara së bashku këto dimensionet e pajisin studentin në Ciklin e Parë të studimit Bachelor me njohuri të përgjithshme dhe disa aftësi bazë në lidhje me punën apo specializimin e mëvonshëm si mësues, trajner dhe edukator sportiv.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në "Edukim fizik dhe Sporte", plotëson kërkesat specifike në fushën e mësimdhënies bazuar në një kurrikul bashkëkohore të integruar me dinamikën e zhvillimeve ekonomiko-shoqërore dhe profesionale.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka aplikuar në ASCAL më datë 17.05.2024, (Shkresë e IAL Nr. 1185 Prot, datë 17.05.2024, dërgon formularin e aplikimit regjistruar në protokollin e ASCAL). Aplikimi është kryer pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përputhje me parashikimet e Manualit: “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”, i ndryshuar. Me kryerjen e aplikimit, UNIKO ka realizuar procesin e vlerësimit të brendshëm dhe nëpërmjet shërbimit në AMS ka nisur raportin e vlerësimit të brendshëm RVB dhe dokumentacionin mbështetës, pjesë e Dokumentacionit të Vetëvlerësimit të programit (DVV).

Raporti i vlerësimit të brendshëm është përgatitur nga një grup pune i ngritur me Vendimin e Përgjegjësit të Departamentit të Edukimit nr. 3170, dt. 26.12.2024 dhe është konfirmuar vërtetësia e dokumentacionit të përdorur nga GVB për hartimin e RVB. Po kështu ky proces është bazuar edhe në Urdhërin e ASCAL dt. 14.01.2025 “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga “Universiteti Fan.S.Noli, Korçë” ku theksohet se Ekspertë Vlerësimi të Jashtëm janë përzgjedhur: **Prof.As. Robert Çitozi; PhD. Rovena Elmazi**, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, (GVJ) është mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL Z. Arbri Ndreka. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi i ekspertëve të jashtëm ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UNIKO të vëna në dispozicion nga sistemi AMS. Ecuria e procesit të vlerësimit ka vazhduar në përputhje me agjendën e punëve të përcaktuara nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi dhe vizitën në institucion në datë 05-06 Mars 2025 ku mori takime të rëndësishme me aktorët kryesorë të këtij programi studimi duke filluar me Dekanen e Përgjegjësen e njësisë bazë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, me personelin administrativ, sekretarinë mësimore dhe më pas vizitoi ambientet e UNIKO dhe ambientet ku realizohet mësimdhënia teorike e praktike për këtë program studimi. Pas vizitave në UNIKO, grupi i punës filloi hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm në përputhje me të gjitha templates apo guidën e hartimit të tij.

IAL është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.06.2025, pëmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.36/78 Prot, datë 23.06.2024. IAL njofton në ASCAL më datë 30.06.2025, me anë të shkresës me Nr. 1356/1 Prot, datë 27.06.2025 “Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DE	Departamenti i Edukimit
DRAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
FEF	Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personeli Akademik Efektiv
PAK	Personeli Akademik me Kontratë
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
RVJ	Raport i Vlerësimit të Jashtëm
UNIKO	Universiteti Fan.S.Noli, Korçë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKA	Zyra e Karrierës dhe Alumni
ZBNJ	Zyra e Burimeve Njerëzore



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë është institucion i Arsimit të Lartë, i njohur me ligj si i tillë. Veprimtaria e tij bazohet në Nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin Nr. 80/2025 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, në Statut dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tyre. Programi i studimit BA në “Edukim Fizik dhe Sporte” ofrohet në pajtim me interesat kombëtare dhe synon të kultivojë tek studentët, ndër të tjera, vlerat akademike, kulturore e kombëtare, në përputhje dhe me misionin e UNIKO të përcaktuar qartë në Statutin e tij sipas të cilit “Programi është në harmoni të plotë me interesat kombëtare të vendit në fushën ekonomike, politike, sociale, kulturore, sportive, gjeopolitike” etj. Ai synon të kontribuojë në përmirësimin e standardeve, cilësisë dhe rritjen e vlerës së edukimit fizik dhe sportit si një nga faktorët e rëndësishëm për krijimin e një shoqërie më të shëndetshme sot dhe në të ardhmen. <i>-Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë</i> <i>-Shtojca 1.3 Plan i Strategjik i Universitetit “Fan S. Noli” 2022-2027, Vizioni UNIKO</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë ka si mision të krijojë, transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë edukimin fizik dhe sportet. Gjithashtu, UNIKO ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj. Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte” ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për të formuar specialistë të aftë, të rrisë cilësinë e kërkimit shkencor, si edhe të përmirësojë shërbimet ndaj studentëve, qëllime të cilat janë në një linjë me Rregulloren e Studimeve në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë (FEF), në të cilën përcaktohet qartë se misioni i FEF. Programi Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” ka për qëllim të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqendruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe, të domosdoshme për t’i përdorur në karrierën

	profesionale. -Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë -Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Universitetit "Fan S. Noli" 2022-2027, Misioni UNIKO -Shtojca II.10 Rregullore e brendshme e Departamentit të Edukimit, Neni 7 -Shtojca 4.1 tabela 3 Numri i programeve të studimit që ofron Departamenti -Shtojca I.3, Plani Strategjik i Universitetit "Fan S. Noli" 2022-2027, Pika 3, Kuadri strategjik, misioni dhe vizioni. -Shtojca II.11 Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Në Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" theksohet "Programi synon formimin e shprehive të veçanta në një shumëllojshmëri profesioneve si trajnerë në lloje të ndryshme të sportit me moshat, drejtues i procesit mësimor të edukimit fizik, sportit e shëndetit në shkolla, specialist i përgatitjes dhe fitnesit në palestra, në guida turistike, në menaxhim të sportit etj., që japin mundësi pune sipas kërkesave të tregut". Ai është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UNIKO dhe me Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF). Si përfundim GJV del në përfundimin se strategjia e zhvillimit të programit të studimit, si pjesë e strategjisë së përgjithshme të institucionit garanton përputhshmërinë e objektivave në nivel institucional, duke i harmonizuar me ato të programeve të ciklit të dytë. -Shtojca I.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli" - Kreu VI, Neni 52, Pika (3) -Shtojca I.2 Rregullorja e UNIKO Kreu VI, Neni 43 -Shtojca I.1 Statuti i UNIKO, Kreu I, Neni 2
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Njësia bazë, Departamenti i "Edukimit", DE që ofron programin e studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" është pjesë e FEF-së dhe e ofron këtë program studimi që prej vitit 2019, kur pranë UNIKO, u miratua hapja e programit të studimit "Edukimi Fizik dhe Sporte" pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë. Departamenti i Edukimit për mbarëvajtjen dhe funksionimin korrekt e mbi baza shkencore dhe bashkëkohore e këtij programi angazhon personel akademik efektiv ku përfshihen edhe pedagogë të departamenteve të tjera të UNIKO, personel akademik me kontratë si edhe personel ndihmes akademik të cilët kanë përvojën dhe formimin e duhur shkencor për të ofruar programin e studimit. -Shtojca I.25 Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

	<i>për hapjen e Programit të Studimit</i> <i>-Shtojca I.27 Personeli akademik dhe ndihmës akademik i FEF, për secilin nga 3 vitet</i> <i>-Shtojca I.28 Të dhëna për personelin akademik që mbulon disiplinat e Programit të Studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"</i> <i>-Shtojca I.29 Të dhëna për personelin akademik të Departamentit të Edukimit</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Në Rregulloren e Njësisë kryesore theksohet "Zhvillimi i programeve të reja të studimit bëhet në përshtatje me nevojat e tregut, kushtet ekzistuese dhe perspektivat e zhvillimit të vendit". Referuar programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", rezulton se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik e Sporte", ofrohet në përputhje me fushën e drejtimet akademike të institucionit, klasifikimin dhe kodifikimin e programit të studimit. Ky program mban numrin 6 të kornizës shqiptare të kualifikimit, të ciklit të parë të studimeve (Bachelor), tre vite studimi, me 180 kredite ECTS, zhvillohet në gjuhën shqipe. Ai synon formimin e shprehive të veçanta në një shumëllojshmëri profesionesh si trajnerë në lloje të ndryshme të sportit me moshat, drejtues i procesit mësimor të edukimit fizik në shkollë, specialist i përgatitjes dhe fitnesit në palestra, guidë turistike, menaxherë të sportit etj., që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës. Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MAS. UNIKO me vendimin nr. 65 të datës 20.02.2023 ka miratuar propozimet për kodifikimin e programeve të studimit dhe i ka përcjellë ato për miratim përfundimtar në MAS brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022. <i>-Shtojca I.39-Kodifikimi i programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i> <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu II, Neni 7 dhe Kreu V, Neni 37.</i> <i>-Shtojca I.30 Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Edukimit</i>
Konkluzione	Si GVJ jemi të mendimit që programi i studimit BA në "Edukim Fizik dhe Sporte" ofrohet në pajtim me interesat kombëtare dhe synon të kultivojë tek studentët, ndër të tjera, vlerat akademike, kulturore e kombëtare, në përputhje dhe me misionin e UNIKO të përcaktuar qartë në Statutin e UNIKO dhe është në përputhje

	me Strategjinë e Zhvillimit të UNIKO dhe me Rregulloret e FEF-së. Na rezultojnë se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik e Sporte" ofrohet në përputhje me fushën e drejtimeve akademike të institucionit, klasifikimin dhe kodifikimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ, konstaton se Njësia bazë - DE më qëllim që të ofrojë në mënyrë sa më korrekte, shkencore e bashkëkohore programin e studimit, si dhe të sigurojë mbarëvajtjen e tij vendos marrëdhënie bashkëpunimi edhe me departamentet e tjera në UNIKO. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve institucionale reciproke mes njësive kryesore, Departamenti i Edukimit përpara fillimit të vitit akademik i paraqet këtyre Departamenteve kërkesën për pedagogë, për të ofruar lëndët specifike në programin e studimit Bachelor në "Edukim Fizik e Sporte", siç janë lëndët biomjekësore apo psikosociale. Pjesë përbërëse e procesit të monitorimit të vazhdueshëm është dhe NJSBC-ja, e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e mësimdhënies dhe të proceseve të lidhura me të. Gjithashtu, për të siguruar cilësinë e vazhdueshme në ofrimin e programit të studimit në departament bëhet dhe analiza e punës mësimore dhe shkencore e personelit. Në Rregulloren e UNIKO janë të përcaktuar qartë elementët përbërës të raportimit për veprimtaritë e kryera nga çdo njësi në UNIKO dhe strukturat përgjegjëse për to. -Shtojca I.2 Rregullore e UNIKO, Kreu III, Neni 23 -Shtojca I.2 Rregullore e UNIKO, Kreu V, Neni 29 -Shtojca I.2 Rregullore e UNIKO, Kreu III, Neni 24
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e GVB-së, ne si GVJ, konstatojmë se për përmbushjen e objektivave mësimore e formuese të studentëve, DE ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme me synim dhe qëllim zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në institucionet e arsimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	parauniversitar, si edhe me Bashkinë e Korçës për shfrytëzimin e hapësirave e terreneve sportive. UNIKO disponon një sërë marrëveshesh bilaterale me institucione homologe si brenda dhe jashtë vendit. Ky fakt reflektohet drejtpërdrejtë, në mundësinë e stafit për të qenë pjesë e mobiliteteve, trajnimeve, pjesëmarrjes në aktivitete dhe projekte kërkimi, zhvillimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në veçanti GVJ konstaton se ka marrëveshje në funksion të programit të studimit me institucione që disponojnë terrene sportive cilësore për zhvillimin e lëndëve sportive dhe praktikave mësimore. <i>GVJ sugjeron që gradualisht UNIKO të investojë që të ketë infrastrukturën e tij të objekteve sportive dhe laboratorike në mënyrë që të mbyllet brenda UNIKO cikli i praktikave sportive të programit të studimit. Kjo do eliminonte lëvizjet e studentëve në distanca nga IAL-ja.</i> Shtojca I.31 Marrëveshjet institucionale. Shtojca I.32 Marrëveshjet e bashkëpunimi midis FEF, universiteteve, institucioneve të tjera, dhe biznesit
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Konstatojmë që UNIKO ka një numër marrëveshesh me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke ndjekur një politikë hapje institucionale për shkëmbime eksperiencash, programesh e stafesh akademike. Ai e ka përcaktuar këtë politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofron. FEF ka një rrjet marëdhëniesh bashkëpunimi e partneritetesh nëpërmjet të cilëve organizon vizita studimore, praktikave profesionale të studentëve, punë vullnetare në komunitet, etj. FEF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (në vazhdim DRAP) për kryerjen e praktikës profesionale dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta. Departamenti në koordinim të plotë me FEF, u mundëson studentëve kryerjen e praktikës mësimore sipas specifikave, duke bashkërenduar veprimtarinë praktike në palestra sportive, terrene sportive pranë ekipeve sportive etj. <i>Departamenti i Edukimit duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve për studentët dhe stafet akademike në të ardhmen e afërt sidomos në këtë fazë ku është prioritet ndërkombëtarizimi i universiteteve shqiptare.</i>

	Shtojca I.33 Marrëveshja e bashkëpunimi midis FEF dhe DRAP. Shtojca I.34 Lojërat Olimpike "Rroke Sportin" projekt me financim të grupit "Balfin"			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Ndonëse më pak se 6 vite aktivitet akademik në këtë program studimi, GVJ mësoi se çdo vit nga Departamenti i Edukimit hartohet një raport vjetor i përfitimit prej marrëveshjeve në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve. GVJ konstaton se FEF në funksion të realizimit të praktikave sportive ka disa marrëveshje bashkëpunimi me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Departamenti i Edukimit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me klube sportive, shoqata sportive, qendra rehabilitimi apo fitnesi etj. Në gjykimin tonë ky numër marrëveshjesh me institucione, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave sportive, krijojnë kushtet dhe mundësitë që këto segmente shumë të rëndësishme të formimit profesional të realizohen me cilësi. Gjithashtu institucioni dhe njësitë përgjegjëse janë në kërkim të vazhdueshëm të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve potencialë. -Shtojca 2.26 Raportet vjetore të veprimtarisë të fakultetit të edukimit dhe filologjisë. -Shtojca I.35 Relacion për përfitimet nga praktika profesionale.			
Konkluzione	GVJ konkludon që për arsyet e mangësive të marrëveshjeve me institucionet e njëjta apo të ngjashme brenda dhe jashtë vendit DE është disi i vonuar në procesin e ndërkombëtarizimit dhe të mobiliteteve të stafëve akademike apo studentëve në programe si Erasmus + etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është i strukturuar në 3 vite shkollorë dhe 6 semestra të rregullt. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41 datë 24.1.2018, e ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). A - duhen 15-20%, janë faktike 33 ECTS ose 18.3 % ✓ B - duhen 50-55%, janë faktike 97 ECTS ose 53. % ✓ C - duhen 12-15%, janë faktike 26 ECTS ose 11% !! D - duhen 10-15%, janë faktike 18 ECTS ose 10 % ✓ E - duhen 3-5%, janë faktike 6 ECTS ose 3.33 % ✓ Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është organizuar në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban mesatarisht 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimit të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 180 ECTS. <i>-Shtojca II.1 Kurrikula e Programit të Studimit dhe Shtojca II.2 Plan i mësimor i Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale	Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” thuhet “Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me

e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	veprimtaritë mësimore të tij”. Duke iu referuar përmbajtjes së Programit të studimit “Bachelor në Edukim Fizik e Sporte” kategorizimi i lëndëve në programin Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” mundëson pajisjen e studentëve me njohuri dhe kompetenca të domosdoshme për të qenë specialistë të aftë në fushën e edukimit fizik dhe mbështeten në bazën ligjore përkatëse. Programi i krijon studentit hapësirën e mjaftueshme për thellimin e dijeve në disiplina ku ai shpreh interes. Kjo realizohet nëpërmjet të drejtës së studentit për të zgjedhur një numër modulesh (lëndë me zgjedhje), sipas përcaktimeve në kurrikulën e programit, por dhe nëpërmjet tezës së diplomës. Programi studimit është edhe në përputhje me direktivat e Bashkimit European, në zbatim të kërkesave të projektit të Bashkimit European i quajtur AEHESIS, ku ka përcaktime specifike për univeristetet e sportit në Europë. -Shtojca II.23 VKM nr.514, datë 20.9.2017 Lista Kombëtare e Profesioneve -Shtojca II.1 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik Dhe Sporte” -Shtojca II.16 Programet lëndore
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Mbështetur në (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, "Për elementet programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bëjnë pjesë 9 module; Në kategorinë B bëjnë pjesë 20 module; Në kategorinë C bëjnë pjesë 8 module; Në kategorinë D bëjnë pjesë 4 module; Në kategorinë E bën pjesë 1 veprimtari përmbyllëse e cila është provimi i përgjithshëm përfundimtar, Bazuar në legjislacionin në fuqi shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt. -Shtojca II.3 Struktura e planit mësimor të Programit të Studimit Bachelor -Shtojca II.11 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik Dhe Sporte” -Shtojca II.2 Plan i mësimor i Programit të Studimit 2024-2027
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për	GVJ konstaton se në programin e studimit të Edukimit Fizik dhe Sporte është i përfshirë edhe kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit i cili është hartuar duke marrë në

realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	konsideratë bazën ligjore në fuqi. Sipas këtij kuadri janë parashikuar Detyrimet Përmbyllëse (Simboli E), ku veprimtaria formuese është përcaktuar provim përfundimtar me 6 ECTS ose 3.33 % të totalit të ECTS-ve të programit të studimit. Në vitin e tretë të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte”, studentët zhvillojnë lëndën praktikë mësimore, studentët zhvillojnë praktika vëzhguese të orëve të mësimit të edukimit fizik në shkollat e qytetit. Praktika mësimore profesionale është pjesë përbërëse e planit mësimor të programit të studimit, vlerësohet me 7 ECTS dhe pasqyrohet si lëndë plotësuese e kategorisë D në semestrin e dytë, të vitit të tretë. Kryerja e praktikës profesionale nga studentët është e detyrueshme. Praktika profesionale, përgatitja për provime dhe teza e diplomës përfshihen në planin mësimor dhe strukturën e vitit akademik . Udhëzuesi i praktikës dhe Udhëzuesi i diplomës janë orientuesit bazë të studentit . <i>-Shtojca II.4 VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 "Për elementët e programit të studimit ofruar nga institucionet e arsimit të lartë"</i> <i>-Shtojca II.2 Plani mësimor i Programit të Studimit</i> <i>-Shtojca II.16 Programet lëndore (Syllabus)</i> <i>-Shtojca II.5 Struktura e vitit akademik dhe organigrama e UNIKO</i> <i>-Udhëzuesi i praktikës ndodhet në (Shtojca II.6) dhe Udhëzuesi i punimit të diplomës ndodhen në (Shtojca II.7), njëkohësisht gjenden edhe në zyrën e informimit të studentit në FEF dhe në Departamenti i Edukimit/Udhëzuesit.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të	Programi studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte, ka përmbajtje të ngjashme në nivel me mbi 70 për qind, me programet që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, me universitetet e vendit, në veçanti me universitetin publik UST të Tiranës. Nëse studentët kërkojnë të



kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	transferohen në një tjetër universitet, ngjashmëria e përmbajtjes së programit duhet të jetë së paku 70%. Konstatohet që kurrikula ka reflektuar ndryshimet, referuar VKM Nr. 41, (Shtojca II.4) dhe praktikën më të mirë. Kurrikula përafrohet me programet e ngjashme kombëtare në masën rreth 80% . <i>-Në linkun përkatës shfaqen lëndët e Programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan.</i> https://uniel.ems.al/school/program/0612bb2c-463f-42d2-9d91-b25f00a9ec4d.aspx			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar kjo në shkresën 295 dt 16.01.2023 (Për afatet e kodifikimit të programeve të studimit, ofruar nga Institucionet e Arsimit të Lartë) dhe vendimi nr 310 dt 11.05.2022 (Për specifikimin dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë) e sjellë nga MAS konstatuam se UNIKO ka bërë në MAS me shkresë Nr.85/3, datë 21.02.2023 "Dërgohen propozimet për kodifikim të programeve të studimit të ofruara nga UNIKO", dhe janë në pritje të marrjes së kodit të këtij programi studimi. <i>-Shtojca II.28 Urdhër nr 73.datë 15.03.2022 i QSHA për regjistrimin e formës së diplomës në Regjistrin e Diplomave</i> <i>-Shtojca I.23 Procedura e kodifikimit</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Konstatohet që për momentin në FEF nuk ka programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaja, ndonëse në kuadër të ndërkombëtarizimit të IAL-ve në Republikën e Shqipërisë. Programi i studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" subjekt i këtij raporti vlerësimi ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe është një program kurrikula e të cilit bën përpjekje të vazhdueshme për tu afruar me programe të ngjashme studimi brenda vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.			
Konkluzione	GVJ konstaton që bazuar në zbatimin rigoroz të VKM-së 41 të ndryshuar për kategorizimin e lëndëve dhe ndarjen e krediteve sipas ECTS-së, përputhja me AEHESIS dhe kodifikimi i programit të studimit është në përputhje me kërkesat ligjore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjin. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë (FEF), dhe Departamenti i Edukimit, janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Njësia kryesore është e përbërë nga 4 njësi bazë: 1. Departamenti Edukimit; 2. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 3. Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë; 4. Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë Departamenti i Edukimit në vitin akademik 2024-2025 përbëhet gjithsej nga 12 staf akademik, nga ku 8 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 4 janë staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Departamenti i Edukimit</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>0</td><td>-</td></tr><tr><td>Doc/Dr/PhD</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>4</td><td>4</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>8</td><td>4</td></tr></table> UNIKO është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 02, datë 27/01/2023.(Akreditimi është i vlefshëm deri më 26/01/2027). Të gjitha programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Edukimit janë programe të akredituara ose në proces akreditimi. Departamenti i Edukimit ofron programe studimi në dy cikle studimi: Programe të ciklit të parë. <i>-Shtojca 1.30 -Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Edukimit</i> <i>-Shtojca 4.1. tabela nr.2 tabelat përmbledhëse</i>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Edukimit		PAE	PAK	Prof.Dr	1	-	Prof.Asoc	0	-	Doc/Dr/PhD	3	-	Msc	4	4	Gjithsej	8	4
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Edukimit																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	1	-																			
Prof.Asoc	0	-																			
Doc/Dr/PhD	3	-																			
Msc	4	4																			
Gjithsej	8	4																			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për	GVJ, konstaton se Departamenti i Edukimit që ofron programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte”, ka të angazhuar personel ndihmës akademik, i cili punon për realizimin e praktikave mësimore sportive në palestra apo terrene sportive për realizimin e praktikave laboratorike, në përputhje me bazën ligjore në fuqi, duke përmbushur kështu detyrimet e përcaktuara. Ky personel kryen veprimtari këshillimi për studentët dhe detyra administrative, zgjidh në kohë gjithë problematikat organizative e financiare për																				

realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	zhvillimin e orëve mësimore të lëndëve në mjediset dhe terrenet sportive jashtë UNIKO, mundëson funksionimin optimal të klasave, auditoreve, laboratorëve të zhvillimit të lëndëve mësimore etj. -Shtojca I.30 -Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Edukimit -Shtojca I.27. Personeli akademik dhe ndihmës akademik FEF			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në strukturën e njësive bazë në UNIKO është i parashikuar një koordinator për program studimi i cili e koordinon punën e tij me departamentin. Koordinatori mundet të mbulojë brenda departamentit më shumë se një program studimi të njëjtë apo të përafërt. Ai harton raport periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional. Nga vizita në institucion dhe bisedat me stafin pedagogjik të këtij programi studimi konstatohet që ka harmoni në ndarjen e zbatimit e detyrave. Koordinatori i programit të studimit, përcakton pedagogët përgjegjës (tutorët) sipas kurseve e grupeve, të cilët janë pedagogët që japin mësim pranë njësisë bazë në një vit akademik. Midis koordinatorit të programit dhe drejtuesit të departamentit ekziston një bashkëpunim i vazhdueshëm, në ndihmë të vendimmarrjes për ecurinë dhe zhvillimin e programit. -Shtojca II.10 Rregulloren e brendshme të Departamentit të Edukimit Kreu III, neni 14 -Shtojca 2.9 Vendim i emërimit të koordinatorit të programit të studimit			
Konkluzione	GVJ konstaton që njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi sepse ka gradat dhe titujt sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu eksperiencë akademike dhe sportive e stafëve PAE dhe PAK garantojnë cilësinë teorike dhe praktike të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Q. Stafa

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	FEF dhe Departamenti i Edukimit, zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Departamenti i Edukimit, pjesë e FEF-së përgjegjëse për programin e Edukimit Fizik e Sporteve disponon të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me organizimin, strukturën, si edhe përmbajtjen e programit të studimit. Anëtarët e personelit akademik kanë mundësinë të njihen me Statutin e UNIKO, Rregulloren e studimit të UNIKO me planin mësimor të programit të studimit si edhe syllabuset e lëndëve. Dokumentacioni i hartuar sipas përcaktimeve në Ligjin 80/2015 dhe VKM, Nr. 41 reflekton të gjitha parimet mbi të cilat organizohet dhe menaxhohet veprimtaria e programit të studimit. -Shtojca I.2 Rregullore UNIKO -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF -(Shtojca II.10), Rregulloren e brendshme të Departamentit -(Shtojca II.11), Rregulloren e programit të studimit -(Shtojca II.1) Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” -(Shtojca II.2). Planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Ne si GVJ konstatojmë se Planin mësimor në programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në UNIKO, ka të përcaktuara e të detajuara informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuntimin, ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Duke ju referuar Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 73, pikat 1, 2 si dhe aktet e tjera rezulton se programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, ofrohet në përputhje me përcaktimet ligjore pasi organizohet në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese. Planin mësimor përditësohet çdo vit akademik dhe miratohet nga Senati i UNIKO. Departamenti i Edukimit, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF , në fund të vitit akademik, në një takim të posaçëm argumenton dhe propozon ndryshimet në planin



	mësimor për vitin e ardhshëm. -Shtojca II.2 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik" -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu V, neni 63 -Shtojca II.12. Ndryshimet në planin mësimor të Programit të Studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu III, neni 14, Pika (3).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Si GVJ, konstatojmë se programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret e përgjithshme të pranimit janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe publikohen edhe në faqen zyrtare të Universitetit. Gjithashtu në Rregulloren e Studimeve Bachelor në UNIKO, përcaktohen qartë kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Studentët informohen nga faqja web e UNIKO dhe sigurojnë informacione ndihmëse nga sekretaria mësimore e DE dhe drejtuesi i njësisë bazë. -Shtojca I.1 Statutin e UNIKO, Kreu VI, Neni 55. -Shtojca I.2 Rregulloren e UNIKO Kreu VI, Neni 46 -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu V, Neni 75 -Shtojca II.10 Rregulloren e Departamentit të Edukimit, Kreu II, Neni 9 pika j dhe l -Shtojca II.11. Rregulloren e programit të studimit, Kreu I, seksioni 7 -Shtojca I.26 Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore, FEF Kreu V, neni 66 -Shtojca II.11 Rregulloren e programit të studimit, kreu II, seksioni 8
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në	Konstatojmë se syllabuset e lëndëve të përfshira në programin e studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", strukturohen sipas formatit që miratohen në nivel institucioni. Në fillim të semestrit përgjegjësi i departamentit miraton syllabuset të cilat janë hartuar sipas udhëzimeve specifike dhe në to paraqiten përmbledhja dhe rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, temat për çdo javë të veprimtarisë mësimore (leksion, seminar, ushtrime), forma e kontrollit të dijes si edhe literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. Programet lëndore i vihen në dispozicion studentëve nëpërmjet sistemit digjital Pitagora. <i>Konstatojmë që është e nevojshme që pas këtij akreditimi disa</i>

përputhje me formatet e miratuara.	nga syllabuset të rishikohen në mënyrë që për çdo temë mësimore duhet vendosur në krah literatura përkatëse sepse në jo pak syllabuse ajo është e vendosur formalisht dhe që nuk përputhet me tekstin e rekomanduar. Po kështu duhet parë me kujdes tabela e vlerësimit të kontrollit të vazhduar sepse në jo pak syllabuse krijon konfuzion në plotësimin e 100% të vlerësimit. Sugjerojmë që të thjeshtohet dhe të bëhet më e qartë ky element shumë i rëndësishëm i syllabusit. -Shtojca I.1 Statuti i UNIKO, Kreu I, Neni 4, Pika (1). -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu V, Neni 77. -Shtojca I.14 Udhëzuesi për përgatitjen e dokumentacionit mësimor dhe dosjen e pedagogut -Shtojca I.6 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Çdo vit akademik, në Departamentin e Edukimit, përgjegjës për programin, pedagogët titullarë të lëndëve, reflektojnë për përmirësimet në programin e studimit. Konstatojmë që ndonëse vetëm 5 vite jetë si program studimi, stafi akademik ka formimin e nevojshëm për të bërë ndërhyrjet përmirësuese pas mbylljes së ciklit të parë 3 vjeçar bachelor. Syllabuset paraqiten nga titullari i lëndës dhe pasqyrojnë çdo vit përmirësimin me njohuritë bashkëkohore dhe të metodave mësimore të përshtatshme në funksion të cilësisë së përgatitjes së studentëve. Rishikimi i komponentëve mësimorë mbështetet tek opinionet e marra nga studentët gjatë anketimeve apo diskutimeve të hapura në klasë. Analizat e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, të cilat realizohen në mënyrë periodike, identifikojnë probleme dhe parashikojnë masat e nevojshme për përmirësimin e treguesve të cilësisë të programit të studimit. Konstatojmë që në UNIKO dhe FEF funksionon një sistem i organizuar për të transmetuar tek studentët informacione rreth programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu V, Neni 69,70, -Shtojca II.25 Raport vlerësimi të brendshëm NJSBC -Shtojca II.17 Studimi i tregut të punës, vlerësimi i nevojave për njohuri, aftësi dhe kompetenca për Programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” -Në dosjen e pedagogut, çdo pedagog ka të depozituar pyetësorët e organizuar për çdo lëndë/modul në përfundim të lëndëve/moduleve që ai mbulon. -Shtojca II.12 Relacion për ndryshime në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe

	Sporte" -Shtojca I.26 Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore të tij, Kreu V, Neni 63			
Konkluzione	GVJ konstaton që programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë të studimit. Ndonëse kemi konstatuar problematika të riparueshme tek disa syllabuse sidomos tek tabela e vlerësimit të kontrollit të vazhduar sepse në jo pak syllabuse krijon konfuzion në plotësimin e 100% të vlerësimit ndaj ka vend për vetëpërmirësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015, Neni 73 thuhet: "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" thuhet se: Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Në përfundim të programeve të ciklit të parë të studimeve lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konkludon se ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", për nga emërtimi, përmbajtja, mundëson pajisjen e studentëve me njohuri dhe kompetenca kyçe që i shërbejnë në ushtrimin e profesionit në të ardhmen. Shpërndarja e orëve praktike dhe teorike pasurojnë përvojën e të nxënës si dhe u mundëson studentëve aplikim të drejtpërdrejtë praktik të njohurive. Ky model i shpërndarjes së moduleve, përmbajtja e përgjithshme e moduleve dhe transmetimi i njohurive lehtësojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve në funksion të punësimit të

	tyre. <i>-Shtojca II.3 Struktura e planit mësimor të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave realizohet mbështetur në VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Kategoritë mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A, B, C, D dhe E. Lëndët e ofruara janë ndërtuar me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre për t'u punësuar pas mbarimit të ciklit të dytë të studimeve si mësues të edukimit fizik dhe sporteve por dhe në fushat e aktivitetit fizik për shëndet, fitnesit dhe rehabilitimit fizik. Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë dhe në vazhdim kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Konstatohet që emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. <i>-Shtojca II.19 CV e stafit akademik</i> <i>-Shtojca I.31 Marrëveshje institucionale.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstaton se struktura e programit është ndërtuar në përputhje me Kartën e Bolonjës, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e pasur të stafit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" në UNIKO parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin e krediteve dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndët specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Raporti teori praktikë, sidomos për lëndët sportive që zhvillohen në terrene sportive e palestra, është i tillë që favorizon aftësimin praktik me shprehitë praktike sportive. <i>-Shtojca II.3 Struktura e planit mësimor të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"</i> <i>-Shtojca II.4 VKM Nr. 41, Shtojca 1, Tabela 1 dhe Pika 2.1 (c) (ç)</i> <i>-Shtojca I.33 Marrëveshjet e bashkëpunimi të FEF dhe DRAP.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit	GVJ konstaton se natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në kredite siguron integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një lëndë dhe aplikimeve të mundshme



teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	praktike dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese. Statuti i UNIKO ka material të plotë mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Proceset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatore të institucionit dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre. Për realizimin e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij janë shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare duke rritur kështu mundësinë e transferimit dhe mobilitetit të studentëve si dhe mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve apo vazhdimin e ciklit të dytë të studimeve. <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF</i> <i>-Shtojca II.27 Model programi lëndor, syllabus</i> <i>-Shtojca II.11 Rregullore e programit të studimit 2023-2026, Plani mësimor i Programit të studimit</i> <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Neni 66</i> <i>-Shtojce I. 37 Procedura e ekuivalentimit për transferimin e studentëve</i>
Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ konkludon se syllabusët e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përgjithësi në përputhje me përcaktimet të VKM 41, dhe 185 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Biblioteka digjitale e UNIKO (U-LIBRARY) mundëson akses në EBSCO Publishing Databases, ku stafi akademik dhe studentët mund të regjistrohen, të përdorin dhe shkarkojnë revista / periodikë / libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Gjatë shqyrtimit të syllabuseve të programeve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", konstatohet se vetëm një pjesë e tyre janë të përditësuara dhe janë të bazuara në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Por, konstatohet edhe disa problematika të tjera të theksuara edhe më lart: <i>Sugjerohet që syllabusët pas këtij akreditimi të përditësohen</i>



	<i>me synime të qarta për përmirësimin e tyre në të ardhmen në favor të një mësimdhënie më cilësore. Mos të harrojmë se kemi edhe autorë shqiptarë autoritete të padiskutueshme në fushën e sportit që kanë tekste universitare të shkëlqyera dhe me vlera të pakundërshtueshme.</i> -Shtojca IV.22 Lista e librave për studentët e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” -Shtojca II.16 Programet lëndore ndodhen në shtojcën përkatëse.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë e specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Misioni i Departamentit të Edukimit në realizimin e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor, por edhe tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve (ka jo pak magësi) dhe praktikave. Si përfundim, synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale. -Shtojca IV.22 Lista e librave për studentët e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” -Shtojca II.16 Programet lëndore ndodhen në shtojcën përkatëse
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë e specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, Master Profesional apo Shkencor. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat të tregut të punës. Lista e Profesioneve/Mundësive për punësim të studentëve që përfundojnë studimet në Programin Bachelor në “Edukim Fizik

	dhe Sporte" pranë UNIKO janë: institucionet parauniversitare (shkolla), qendra të fitnesit, qendra të kujdesit të peshës, palestra, organizata jofitimprurëse me projekte nga fusha e sportit, administratë qendrore dhe vendore, qendra rekreacioni, institute sporti etj. -Shtojca I.30-Programet e studimeve të ofruara nga Departamenti i Edukimit. -Shtojca II.24-Të dhëna mbi gjurmimin e studentëve të diplomuar -Shtojca II.20-Modulet dhe ngarkesa mësimore për pedagogët me kohë të pjesshme			
Konkluzione	GVJ konstaton që struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve si dhe kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, modulet, lëndët mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve në këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucionit i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Po ti referohemi Statutit të UNIKO, hartimi i Programit të Studimit përcaktohet si kompetencë e Departamentit të Edukimit dhe dërgohet për miratim në Senatin Akademik. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe përmirësohet edhe nëpërmjet konsultave me institucionet homologe sidomos me UST-në. Gjithashtu në FEF realizohen pyetësorë me studentët nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion mbi programin e studimit, si edhe është miratuar paketa e instrumenteve matëse të cilësisë në UNIKO në të cilën përmbahen pyetësorë që do të zhvillohen me studentë që do të diplomohen, me punëdhënësit etj. Edhe në analizën vjetore të veprimtarisë së qendrës së karrierës dhe alumnit, FEF vlerëson

	nevojat e tregut të punës të evidentuara nga studimet, takimet e drejtpërdrejta, por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit, ashtu edhe me ata akademikë. GVJ konstaton se rrjeti ALUMNI shërben si urë lidhëse midis studentëve të diplomuar dhe studentëve aktualë, i shërben shkëmbimit të përvojave dhe orientimit të studentëve në jetën profesionale. <i>-Shtojca II.17 Studimet e plota të tregut të realizuara nga Departamenti i Edukimit</i> <i>-Shtojca II.22 Analiza e veprimtarisë së qendrës së karrierës dhe alumnit</i> <i>-Shtojca II.24 Të dhëna mbi gjurmimin e studentëve të diplomuar</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Po në Statutin e UNIKO mbi të drejtat e studentit, përcaktohet edhe e drejta e studentëve për të shprehur vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të UNIKO. Në përmbushje të kësaj të drejte themelore si edhe në funksion të përmirësimit të programit të studimit, studentët janë të përfshirë në struktura të ndryshme si në: - Senatin Akademik të UNIKO në masën 10% të numrit të anëtarëve të Senatit. - Këshillin e Etikës të UNIKO. - NJSBC në nivel institucioni dhe në nivel fakulteti. - Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe Komisionin e Zgjedhjeve në Fakultet (KZF). Gjithashtu, në paketën e miratuar të instrumentave matës të cilësisë në UNIKO, në funksion të përmirësimit të programit të studimit mbi bazën e përgjigjeve të marra, përfshihen ndër të tjerë edhe pyetësorë për studentët që do të diplomohen në UNIKO. <i>-Shtojca I.1 Statuti i UNIKO, Kreu VIII, neni 79, Pika (2)</i> <i>-Shtojca I.1 Statuti i UNIKO, Kreu VIII, neni 80, Pika (1)</i> <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, neni 99 dhe neni 101 Pika 1.</i> <i>-Shtojca I.1. Statuti i UNIKO, Kreu III, neni 17, Pika (5) dhe (6)</i> <i>-Shtojca I.1 Statuti i UNIKO, Kreu III, neni 29, Pika (4)</i> <i>-Shtojca I.1 Statuti i UNIKO, Kreu IX, neni 84, Pika (2).</i> <i>-Shtojca I.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për autoritet dhe organet drejtuese UNIKO - Kreu II, neni 6, Pika 1 (a) dhe Neni 7, Pika (2)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson,	Nëse i referohemi Strategjisë së Zhvillimit të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik e Sporte", ky program

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	studimi është organizuar në bazë të marrëveshjes së Kartës së Bolonjës dhe legjisllacionit në fuqi. Kurrikula e programit të ofruar për nivelin Bachelor, është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të Universitetit të Sporteve Tiranë, universiteteve homologe të Bullgarisë, Athinës, etj. Zhvillimi i kurrikulës është një ndër prioritetet strategjike në Strategjinë e Zhvillimi të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte”. Në programin e studimit të ofruar, Departamenti i Edukimit DE, është përpjekur të përshtasë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore, sportive dhe shkencore të vendit, si dhe të praktikojë modelet më të mira kurrikulare të vendeve fqinje dhe atyre të BE-së. Stafi akademik i Departamentit të Edukimit mban marrëdhënie të vazhdueshme me shoqatat sportive si: Shoqata sportive “Tenis Korça” duke mundësuar rekomandimin dhe ndjekjen e studentëve të punësuar. Nga ana tjetër, studentë të punësuar ruajnë marrëdhëniet me Departamentin dhe disa prej tyre kontribuojnë me njohuritë dhe përvojën praktike të fituar. -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, Neni 106 -Leksionet e hapura të organizuara nga Departamenti i Edukimit janë të pasqyruara në profilin e UNIKO, https://www.facebook.com/photo/. -Të dhëna të plota për projektin gjenden në faqja eeb të UNIKO tek kategoria Projekte.			
Konkluzione	GVJ konstaton që institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Njësia përgjegjëse konsultohet dhe merr parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Gjithashtu konstatojmë që institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimitdhënies, mësimitnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i Planit Mësimor GVJ konstaton se: Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Sipas programit të studimit shpërndarja rezulton në: Leksione; Seminare; Lab/Ushtime; Praktikë/Detyra; Praktikë Profesionale; dhe Diplomë/Provimi Formimi. Programi lëndor (syllabus) i secilës lëndë miratohet nga Senati dhe nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu dhe Drejtuesi i Departamentit. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet rektoratit të UNIKO përmes Njësisë kryesore për miratim. Pas miratimit, DE-ja ndjek realizimin e aktiviteteve. Në total për këtë program studimi, për të treja vitet e studimit, orët në auditor janë: Leksione = 819 orë, Seminare = 622 orë mësimore, laborator = 71 orë, praktika mësimore = 200 orë, praktika sportive = 661 orë, dhe në total 2373 orë mësimore në auditor dhe 2127 orë jashtë auditorit!!! Orët jashtë auditorit duhet të jenë jo më pak se gjysma e orëve totale 4500 pra jo më pak se 2250 orë. Mendojmë që në të ardhmen ky raport duhet korigjuar. <i>-Shtojca II.2 Plani mësimor i programit të studimit 2024-2027</i> <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF</i> <i>-Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Edukimit</i> <i>-Shtojca I.31: Marrëveshje Institucionale, Marrëveshja me Bashkinë në fushën e Edukimit Fizik dhe Sporte</i> <i>-Shtojca II.2 Plani mësimor i programit të studimit 2024-2027</i> <i>-Shtojca I.33 Marrëveshje bashkëpunimi midis FEF dhe DRAP</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u	Duke iu referuar rregullores së programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik e Sporte", ku është e theksuar që programet e

përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	studimit dhe puna akademike ka në fokus studentin, kërkesat e tyre, duke synuar formimin e tyre shkencor dhe profesional për të qenë nesër misionarë të dijes kudo që të punojnë. Format kryesore të mësimit janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, esetë, punët praktike, punimet vjetore, projektet e kursit, ekspeditat mësimore, kontrollet me shkrim e detyrat e kursit, provimet e kursit, mbrojtja e tezës së diplomës, gjë e cila reflektohet edhe në syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Gjithashtu shfrytëzohen edhe platformat me sistemin Teams. Në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve, rritet kontakti i studentëve me modulet me karakter profesional, ku iu jepet më shumë rëndësi metodave praktike, me qëllim që studentët të aftësohen në zbatime praktike të njohurive teorike. <i>-Shtojca II.2 Plani mësimor i programit të studimit 2024-2027</i> <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF</i> <i>-Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Edukimit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	Vlerësojmë se UNIKO e mbështet stafin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet leksioneve të hapura, programeve të shkëmbimit që zhvillohen në kuadër të projekteve të ndryshme me qëllim trajnimin lidhur me mësimdhënien apo kërkimin shkencor, apo edhe ditëve të hapura virtuale të cilat mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave në mënyrë virtuale por gjithashtu krijojnë mundësi për bashkëpunime të reja. Në UNIKO, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe nga bisedat gjatë vizitës në institucion, organizohen gjithashtu takime informuese në lidhje me programet kombëtare dhe ndërkombëtare për projektet e kërkimit shkencor, mobilitetin, infrastrukturën kërkimore shkencore. Të gjitha njoftimet, veprimtaritë apo projektet e ndryshme postohen edhe në faqen zyrtare të UNIKO. UNIKO përmirëson dhe menaxhon infrastrukturën e mësimdhënies, nëpërmjet aplikacioneve online të komunikimit si Teams të paketës Office 365 for Education, aplikacionit Google meet, Zoom, EduMeet si dhe trajnimeve të personelit akademik mbi mënyrat e përdorimit të tyre. <i>GVJ sugjeron që njësi bazë DE, e cila mbulon këtë program studimi mundet të jetë më aktive duke qenë ajo organizatore apo bashkëorganizatore e workshop-eve të ndryshme apo konferencave në nivel fakulteti apo universiteti dhe më gjërë</i>

	<i>pse jo me përfshirjen edhe të studentëve ekselentë.</i> https://www.facebook.com/photo/?fbid=1085966656874353&set=pcb.1085986250205727 https://ëëë.facebook.com/profile.php?id=100075842472419 -Shtojca 3.6 TRAJNIME NË MIKROSOFT TEAMS
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Universiteti “Fan S.Noli” Korçë”, bazuar në dokumentacionin e plotë i cili na është vënë në dispozicion, është i qartë në objektivat dhe në strategjitë institucionale të mësimdhënies dhe punon vazhdimisht për përditësimin dhe modernizimin e tyre. Strategjia e mësimdhënies i ka të mirëpërcaktuara qëllimet e veta strategjike në lidhje me mësimdhënien. Për të realizuar këto qëllime UNIKO bazohet në disa parime teorike dhe aspekte praktike që kanë të bëjnë me aktivizimin e metodave të ndryshme të cilat sigurojnë mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore si edhe përdorimin e teknikave aktive të cilat nënkuptojnë pjesëmarrje aktive dhe të ndërgjegjshme të studentit. Në CV-të e personelit akademik si efektiv, po ashtu edhe të personelit akademik me kohë të pjesshme, por edhe gradat e titujt që ky personel disponon vërtetojnë se personel akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe njohurive. Format e larmishme të mësimin që përcaktohen në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, por edhe në syllabuset e programit të studimit dëshmojnë se stafi akademik nxit mendimin krijues dhe kritik tek studenti, njëkohësisht luajnë rolin e tyre si udhëheqës dhe mbështetës ndërtimin e marrëdhënieve reciproke dhe janë në përputhje të plotë me Strategjinë e Mësimdhënies së UNIKO. <i>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe i ngarkesës mësimore vjetore për secilin personel akademik, GVJ, ka disa rezerva mbi disa lëndë/module të cilat jepen nga stafe akademike që nuk e kanë formimin e përgjithshëm dhe të thelluar për të qenë titullarë të këtyre lëndëve apo moduleve. Sigurisht që e njohim problematikën që në IAL-të publike apo private nuk ka më specialitete sporti dhe kjo e vështirëson jo pak gjetjen për çdo modul të një specialisti me formim të thelluar.</i> -Shtojca II.19 - CV e stafit akademik
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë	GVJ konstaton se: DE në bashkëpunim me dekanatin dhe stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm, bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, duke u bazuar në mendimet, opinionet dhe vlerësimet që merren drejtpërdrejtë nga ndërveprimi me studentët dhe këto sugjerime për ndryshim dhe përmirësim

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	reflektohen në syllabuset e lëndëve/moduleve. Vlerësimi i formave dhe i metodave të mësimdhënies bëhet edhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve. Një pyetësor i tillë është hartuar nga Dekanati bazuar mbi Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe shpërndahet nga NJSBC-ja (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) e FEF-së. Të dhënat e nxjerra nga analiza e pyetësorëve pasqyrohen te Shtojca III.10-Raport mbi të dhënat e pyetësorit studentor të FEF. <i>GVI, pasi u njoh me pyetësin e studentëve është e mendimit që ky pyetësor duhet të guxojë edhe për të kërkuar jo vetëm elemente të cilësisë së mësimdhënies, por edhe tek elementet korruptivë apo të mitmarrjes. Kjo mundësi u duhet krijuar studentëve në mënyrë që zëri i tyre të jetë thirrje për ndershmëri e pastërti akademike e morale.</i> <i>-Në dosjen e pedagogut, çdo pedagog ka të depozituar relacionet me shkrim të hartuara në përfundim të lëndëve/moduleve që ai mbulon</i> <i>-Shtojca III.1.Pyetësor fund-kursi</i> <i>-Shtojca III.1 Pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UNIKO si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel universiteti organizon në mënyrë të vazhduar dhe periodike struktura në nivel institucional që kontribuojnë dhe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Një strukturë e tillë të cilën e kërkon edhe Ligji 80/2015 i arsimit të lartë është edhe NJSBC-ja e FEF-së e cila koordinon dhe bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies sikundër është përcaktuar edhe në Manualin e Cilësisë së UNIKO. UNIKO si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel universiteti organizon në mënyrë të vazhduar dhe periodike struktura në nivel institucional që kontribuojnë dhe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Një strukturë e tillë të cilën e kërkon edhe Ligji 80/2015 i arsimit të lartë është edhe NJSBC-ja e FEF-së e cila koordinon dhe bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies sikundër është përcaktuar edhe në Manualin e Cilësisë së UNIKO. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese. Ndërkohë një element shumë i rëndësishëm është pajisja e

	studentëve me njohuri për organizimin dhe zbatimin e lojrave sportive dhe sporteve individuale. Këto shihen si format kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve të edukimit fizik dhe sporteve. Për të rritur bashkëveprimin midis studentëve, detyrat e kursit në programet bachelor zhvillohen përmes prezantimeve në grup. Kjo formë nxit përgjegjësinë dhe rrit respektin e ndërsjellë ndërmjet studentëve, rrit vetbesimin dhe përgjegjësinë duke i motivuar më shumë ata. Raportet e vlerësimit të NJSBC, shërbejnë si bazë për pëmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. -Shtojca 1.26 - Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Neni 10, pika 1 -Shtojca 2.25 Raport i vlerësimit të brendshëm - NJSBC			
Konkluzione	GVJ konkludon që ka disa mospërputhje të nivelit të formimit të përgjithshëm dhe të thelluar dhe lëndëve të shumta sportive që jepen kryesisht nga pedagogët MSc si dhe ka një jetë jo shumë aktive në aspektin e punës kërkimore shkencore pasqyruar kjo në mungesat e workshop-eve apo konferencave në rang kolegj, fakulteti apo departamenti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Universiteti "Fan S.Noli", Korçë në zbatim edhe të ligjit dhe udhëzimeve të MAS ka hartuar dokumenta rregullatore që përcaktojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe bëhen publike për studentët nga pedagogët dhe nga pedagogët e secilës lëndë/modul në fillim të çdo lënde. Këto dokumenta janë: - Rregullorja e Studimeve në UNIKO; - Rregullorja e programit të studimit; Gjithashtu, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara edhe në syllabuset e lëndëve dhe pedagogët informojnë studentët në lidhje me to që në fillim të vitit akademik. Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", specifikon format e kontrollit të dijeve, procedurat e vlerësimit të dijeve, aftësive dhe orienton studentët për mënyrën e zhvillimit të provimeve, praktikës profesionale dhe

	punimit të diplomës. <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, Nenet 83-85</i> <i>-Shtojca II.11 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte”, kreu II në seksionin 5</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se që në javën e parë të fillimit të çdo lënde/moduli, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: - përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, - objektivat e lëndës; - rezultatet e të nxënit të lëndës; - literaturën bazë dhe të rekomanduar; - materialet e tjera të lëndës; - metodën e vlerësimit të lëndës; - shpërndarjen e ngarkesës së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Vlerësimi i lëndës përcaktohet apo është në varësi të tipologjisë së lëndës. Njoftime për provimet dhe vlerësimet vendosen edhe në platformën TEAMS. Kontakte të vazhdueshme me email me studentët mban edhe koordinatori i programit të studimit. Përgjatë vizitës në institucion dhe gjatë intervistave me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi lehtësitë e marrjes së informacionit nga ana e studentëve edhe me platformën online Pitagora. <i>-Shtojca 2.16 Programet lëndore (Syllabuse)</i> <i>-Shtojca.I.6 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në syllabuset e lëndëve testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, që janë: seminareve; provimeve sezonale; punimeve të temave të ndryshme shkencore; esse; projekte shkencore; Këto forma të larmishme u japin mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara sipas përcaktimeve të bëra në lidhje me sistemin e vlerësimit në Rregulloren e studimeve në UNIKO si edhe në Rregulloren e programit të studimit. Për vetë specifikat, e lëndëve praktike sportive, përveç formave të sipërpërmendura përdoren edhe testimet praktike të aftësive sportive, demonstrimeve, aftësimit teknik e metodik sipas disiplinave sportive. Përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talentëve të tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor <i>-Shtojca II.27 Model syllabusi</i>
Kriteri 4. Njësia	Njësia bazë bashkë me stafin akademik vlerësojnë dhe

bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	përmirësojnë vazhdimisht format e metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë edhe studentët në këtë proces nëpërmjet pyetësorëve që zbaton NJSBC-ja. Mendimet dhe sugjerimet e dhëna nga studentët janë objekt diskutimi në departament dhe mbi to reflektohet mbi format dhe metodat e mësimdhënies si edhe mbi mënyrat e vlerësimi të njohurive. Departamenti në përmbushje të rolit të tij, si nxitës, programues, bashkërendues, zhvillues, organizues i veprimtarisë së mësimdhënies, argumenton dhe propozon ndryshime mbështetur në: standardet e mësimdhënies bashkëkohore, vlerësimet dhe gjykimet e stafit dhe të studentëve si dhe raportet e vlerësimit të NJSBC. <i>-Shtojca I.26- Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu I, neni 7.</i> <i>-Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Edukimit.</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nëse i referohemi Strategjisë së Zhvillimit të UNIKO konstatohet se mësimdhënia është një ndër prioritetet mbi të cilat mbështetet zhvillimi i UNIKO dhe ka në thelb përdorimin e metodave të ndryshme të cilat sigurojnë mësimdhënie bashkëkohore dhe cilësore. Ky prioritet mbështetet në dy parime, në implemetimin e metodave të reja dhe të konsoliduara mësimdhënieje, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues, kërkesat e punëdhënësve dhe në funksion të përmirësimit të të nxënit, si edhe nga përdorimi i teknikave aktive të cilat nënkuptojnë pjesëmarrje të ndërgjegjshme të studentit. Referuar syllabuseve të lëndëve mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, ofrohet në forma dhe metoda të larmishme, pasi lidhen direkt me formimin e përgjithshëm të studentëve si specialistë të ardhshëm në fushën edukimit fizik, si trajnerë, si instruktorë fitnesi etj. Format e larmishme të mësimdhënies këtë program studimi inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë komunikim real dhe mbështetjen nga mësimdhënësi, por njëkohësisht ndërtojnë marrëdhënie respekti reciprok mes tyre. FEF mbështet përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në funksion të përmbushjes së objektivave të të mësuarit. Sektori i studimeve dhe Sektori TIK ka mundësuar shërbimet online të mësimdhënies dhe ka organizuar trainimeve të personelit akademik mbi mënyrat e përdorimit të tyre.



	-Shtojca III.7 Trajnime online për bibliotekën digjitale nga EBSCO) -Shtojca III.6- Training in Microsoft Teams) https://m.facebook.com/photo.php?fbid=122108025980668754			
Konkluzione	GVJ konstaton që institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. Konstatohet që kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e programit të studimit e cila është publike dhe njihet nga studentët. Gjithashtu studentët janë të informuar nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Studenti ka mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i një lënde apo nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme: - Provimi i ndërmjetëm; - Niveli i diskutimit në seminare; - Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte) dy detyra praktike; - Provimi përfundimtar. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve, në varësi të tipologjisë së lëndës; Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS nga shkronja A deri në E). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Nota kaluese konsiderohen nga 5 e lart dhe shkronjat nga A deri E. Referuar syllabuseve të lëndëve/moduleve testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Vlerësimi i studentit, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, është i përcaktuar të bëhet mbi bazën e vlerësimit të vazhduar gjatë

	vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi me provim. Në Rregulloren e Programit të Studimit janë të përcaktuara gjithashtu detyrimet që duhet të shlyejë studenti në programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” për lëndët “Provim” në të cilat studenti vlerësohet me provim. Studentët njihen me format e kontrollit të dijeve nga pedagogu i lëndës që në prezantimin e tyre të parë. Për secilën nga format e angazhimit dhe kontrollit të njohurive dhe aftësive të studentit në syllabusin e lëndës përcaktohet pjesa në përqindje ndaj totalit në vlerësimin përfundimtar. Pikët e vlerësimit gjatë vitit hidhen në sistemin Pitagora dhe historiku i tyre ruhet nga sistemi dhe konsiderohen nga pedagogu edhe për sezonet e tjera për efekt vlerësimi në rastet kur studenti është ngelës në sezonin normal të modulit. -Shtojca 1.26 Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore, FEF, Kreu VI, Nenet 83-85 -Shtojca 2.11 rregullore e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” -Shtojca 2.16 Programet lëndore (Syllabuse) Shtojca 3.3 Model procesverbali
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga vizita në institucion konstatohet që, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Në të dy rastet, sekretaria hedh notat në regjistrin përkatës elektronik. Studenti fiton të drejtën e dhënies së provimit të një lënde kur ka qenë i pranishëm në masën e detyrueshme në leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikatat sipas përcaktimeve edhe në Rregulloren për funksionimin e Sekretarisë Mësimore. <i>GVJ sugjeron që UNIKO meqënëse e aplikon programin CleanScore, veçanërisht ky program studimi duhet të kalojë drejt korigjimit 100% të testeve elektronikisht gjë e cila jep dy mundësi: - korigjimin në kohë rekord dhe pa kontestime; - ul në minimum subjektivizmin në vlerësimin e studentit me note. Është shumë e rëndësishme në këtë proces që stafi akademik të trajnohet për mënyrën e hartimit të pyetjeve, nivelit të vështirësisë së tyre etj.</i> -Shtojca III.8 Marrëveshje bashkëpunimi midis AADF dhe UNIKO
Kriteri 3. Vlerësimi	Konstatohet se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në

përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Titullari i lëndës përfshin në testim çështje kryesore të trajtuara në leksione dhe seminare, por është shumë e rëndësishme që pyetjet e tezës mos të lidhen vetëm me leksionet, por edhe me literaturën bazë dhe të rekomanduar të cilat janë pjesë integrale e formimit dhe kontrollit të dijes së studentëve gjatë të gjithë vitit akademik. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve, të përcaktuara nga përgjegjësi i departamentit me jo më pak se 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, në përputhje me parashikimin e bërë në programin lëndor. <i>-Shtojca I.2-Rregullore e UNIKO, Kreu VII, neni 80, Pika (7)].</i> <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, neni 87,</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pikë/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në detyra kursi, projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi ku evidentohen pikat e forta dhe të dobëta dhe jepen rekomandimet përkatëse sesi ato mundet të përmirësohen. Gjatë takimit që patëm me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv nga ana e tyre mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogeve si mundësi konkrete që ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. Pedagogu në tezën e provimit ka edhe seksionin e komenteve për pyetjet me alternativa. Për zhvillimin e testit përfundimtar zhvillohet paraprakisht një seancë sqaruese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe bëhet shpjegimi i kriterëve të vlerësimit. Pas takimit sqarues me studentët, pedagogu plotëson notat. <i>-Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, neni 90, pika 1</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UNIKO, nëpërmjet rregullores mbi disiplinën e studentëve, merr të gjitha masat që sallat e provimeve të jenë të monitoruara, pa praninë e celularëve dhe të librave apo evidencave studentore në tavolinën e provimit si dhe dënon kopjen dhe plagjiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes Këshillit të Etikës. Përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor mekanizma që kontrollojnë plagjiaturën për detyrat me shkrim e sidomos temat e diplomave si detyrime përmbyllëse.

	Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese gjatë vitit. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte” është e qartë se për të siguruar zhvillimin korrekt të provimit lëndës/modulit provimi mbikqyret nga anëtarët e komisionit. Gjithashtu masat për studentët që konstatohen duke kopjuar, janë parashikuar në Rregulloren e Studimeve në UNIKO si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, ku theksohet se studenti që kapet duke kopjuar gjatë provimit, ndërpret provimin, e vlerësohet mbetës në atë lëndë. <i>Sugjerojmë që UNIKO në vazhdim të implementojë sistemin antiplagjiaturë (Turnitin Ephorus), i cili mundëson kontrollin dhe vlerësimin e pastërtisë dhe origjinalitetit të çdo punimi përpara vlerësimit përfundimtar. Kjo gjë do të vlente si për studentët por edhe më shumë për stafet akademike.</i> -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, neni 90, Pika c, -Shtojca II.11 Rregullore e programit të studimit, seksioni 9. -Shtojca I.19 Kodi i Etikës së UNIKO, neni 25
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se në dokumentacionin dhe evidencat e shqyrtuara afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik të UNIKO. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i lëndës përpara shumëfishimit për provim. Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit elektronik, pas periudhës së provimit përfundimtar. Vlerësimi i studentit bëhet në bazë të meritës. Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare. Rezultatet jepen në kohë sipas përcaktimeve në aktet rregullatore të UNIKO, FEF, DE. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij. -Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, neni 92 -Shtojca II.11 Rregullore e programit të studimit, seksioni V
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur	Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit si dhe nga vizita në universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për t’u njohur me vlerësimin si dhe për të

me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankesë në sekretarinë mësimore me anë të një formulari të veçantë, menjëherë pas shpalljes së notave përfundimtare, por para shënimit të notës në regjistrin e arritjeve akademike. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të provimit, nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim në department, i cili përcillet në dekanat me ngritjen e komisionit deri në sqarimin e studentit. Studenti ka të drejtë të ankimohe në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë, brenda ditës për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim, nga data e dhënies së tij dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. -Shtojca 1.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, neni 90		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe komunikimit me studentët gjatë programit të vizitave në institucion, GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të ankohe për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Pedagogu i modulit/lëndës, duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar dhe dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet në sekretarinë mësimore. I gjithë procesi realizohet në zbatim të rregulloreve të FEF dhe departamentit të edukimit DE. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë mbahet në Dekanat. -Shtojca 1.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, neni 90.		
Konkluzione	Konstatojmë që testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në UNIKO realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuar në syllabuset e lëndëve/ moduleve. Është shumë e rëndësishme që pyetjet e tezës mos të lidhen vetëm me leksionet, por edhe me literaturën bazë dhe të rekomanduar të cilat janë pjesë integrale e formimit dhe kontrollit të dijes së studentëve gjatë të gjithë vitit akademik. UNIKO në vazhdim të implementojë sistemin antiplagjiaturë (Turnitin Ephorus), i cili mundëson kontrollin dhe vlerësimin e pastërtisë dhe origjinalitetit të çdo punimi përpara vlerësimit përfundimtar. GVJ sugjeron që UNIKO si pjesë e programit CleanScore edhe këtë program studimi duhet të kalojë drejt korigjimit 100% të testeve elektronikisht.		
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nëse i referohemi Statutit të UNIKO thuhet se: UNIKO harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të UNIKO. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë autonome, e përhershme. Ai vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme mbështetur në: -Hapësirën Europiane të sigurimit të cilësisë; -Legjislacionin në fuqi. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ai organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Bazuar në planin mësimor si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte” që ofrohet nga Departamenti i Edukimit, siguron formimin e shprehive të veçanta, thellimin e njohurive, zhvillimin e kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve, si edhe u garanton të diplomuarve në këtë program studimi njohuritë e nevojshme për vijueshmërinë e karrierës së tyre akademike. <i>-Shtojca II.16 Programet lëndore</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Konstatohet se programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe gjuhën e huaj) përmes lëndëve që ajo ofron, si: - Psikologji e përgjithshme dhe sportive, - Sociologji sportive, - Filozofi e edukimit fizik dhe sportit, - Kultura lëvizore edukimi dhe shoqëria, - Gjuhë e huaj për qëllime specifike, - Statistikë në shkencat sportive, - Aplikimi në SPSS. Sigurisht që edhe laboratorit i teknologjisë së informacionit është një ndihmë e madhe në këtë drejtim sidomos për studentët që do të përballen me sfidat e teknologjisë në çdo hap të jetës së tyre profesionale dhe jo vetëm. <i>-Shtojca 2.1 Kurrikula e programit të studimit</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	-Shtojca II.16 Programet lëndore
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Studentët e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte”, njihen me përmbajtjen e syllabuseve të secilës lëndë/modul si edhe kompetencat dhe aftësitë që duhet të fitojnë ata në çdo lëndë/modul të programit të studimit që në prezantimet e para me pedagogët e secilës lëndë. Gjithashtu personeli akademik evidenton çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. Në përfundim të modulit, pedagogu bën një përmbledhje të materialit të studimit duke orientuar studentët sesi duhet të përgatiten për dhënien e provimit përfundimtar. Gjithashtu, me kërkesë të studentëve, pedagogu i lëndës/modulit zhvillon seanca konsultimesh përpara zhvillimit të provimit. <i>GVJ thekson që kompetencat duhet të shprehen më qartë dhe në forma më të koncentruara në syllabuset e lëndëve/moduleve që na janë vënë në dispozicion.</i> -Shtojca I.26 Rregullorja e brendshme e FEF, Kreu V, neni 67
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Është e qartë që mësimdhënia në institucionet e arsimit të lartë realizohet nëpërmjet formave kryesore të mësimdhënies të përcaktuara në syllabusin e lëndës përkatëse, nëpërmjet leksioneve, seminareve, laboratoreve, detyrave të kursit, ushtrimeve praktike, esseve si edhe praktikave profesionale, të cilat synojnë të zhvillojnë kompetencat profesionale tek studentët. GVJ konstaton se personeli akademik i këtij programi studimi i konsideron diskutimet dhe punën në grup si elemente të rëndësishëm në interpretim apo zgjidhjen e problematikave të ndryshme. <i>Sugjerojmë që njësia bazë duhet të shtojë përpjekjet për angazhimin e studentëve në projekte kërkimore e shkencore, pasi aktualisht konstatojmë që nuk rezultojnë studentë të angazhuar në ndonjë projekt pavarësisht faktit që institucioni i mbështet studentët duke i informuar ata nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit për mundësitë e bursave të studimit apo programe të ndryshme në kuadër të projekteve Erasmus +.</i> -Shtojca II.2 Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në “Edukim fizik dhe sporte”
Kriteri 5. Personeli	GVJ u informua gjatë takimeve me stafin akademik të

akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” mbi aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese të organizuara nga Departamenti i Edukimit si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. Personeli akademik ka lirinë akademike e profesionale të testojë metoda të reja në mësimdhënie dhe duke qenë se syllabuset e lëndëve rishikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. Vlen të theksohet që stafi është i lirë të sugjerojë metoda që kanë rezultuar pozitive dhe të diskutojnë rreth tyre, me qëllim përhapjen e praktikave më të mira. Departamenti i Edukimit organizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë. Departamenti i Edukimi vazhdimisht organizon aktivitetet jashtë strukturës së programit të studimit që nxisin jo vetëm formimin e mëtejshëm të studentëve por pasurojnë edhe anën sociale të tyre. Studentë të Departamentit të Edukimit janë pjesë e ekipeve sportive që përfaqësojnë UNIKO dhe Shoqatën Studentore Sportive të UNIKO, në kampionatet sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar. -Shtojca 2.21 Raportet vjetore të veprimtarisë të departamentit të edukimit -Shtojca 2.26 Raportet vjetore të veprimtarisë të fakultetit të edukimit dhe filologjisë.			
Konkluzione	GVJ konstaton që institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, për zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve edhe në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Personeli akademik i vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe i orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. Mësimdhënia mbështetet mbi bazë kompetencash dhe bazohej tek puna në grup.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	GVJ konstaton se procedura për provimin final para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar nga ku studentët e vitit të tretë mund ta aksesojnë lehtësisht. UNIKO ka hartuar udhëzuesin e provës finale ku jepen udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe realizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Kjo paketë udhëzimesh përmban të gjitha elementet për procedurat e përgatitjes, të konsultimeve, të monitorimit, të vlerësimit të punës trevjecare; përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të programit të studimit. Departamenti harton një bateri pyetjesh me alternativa, për disa lëndë të programit të studimit. Provimi zhvillohet me shkrim. Për të fituar diplomën Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” studenti duhet të ketë marrë 180 kredite dhe të marrë provën finale që realizohet me provim të përgjithshëm përfundimtar apo mbrojtjen e diplomës. <i>-Shtojca I.26 Rregulloren e Brendshme të FEF, Kreu VI, neni 95</i> <i>-Shtojca II.11 Rregulloren e programit të studimit, kreu II seksioni 7</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Çdo informacion dhe udhëzimet mbi provimin e përgjithshëm përfundimtar dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve në UNIKO është i publikuar dhe i aksesueshëm për të gjithë studentët. Pedagogët përgjegjës plotësojnë një fond pyetjesh nga disiplinat kryesore të programit të studimit për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përzgjedhin lektorin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore. Gjithashtu për departamentin është shumë e rëndësishme puna paraprake me studentët, konsultimi i pyetjeve dhe takimet sqaruese me titullarët e lëndëve përpara provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe konsultat metodologjike për mbrojtjen e diplomës. Në mbledhjen e veçantë të njësisë bazë, përcaktohen fushat dhe pedagogët përgjegjës, të cilët do të hartojnë programet orientuese. Në

	rastet e mbrojtjes së temave të diplomës, fillimisht përcaktohen fushat përkatëse për studim, më pas studentët përzgjedhin pedagogë përkatës sipas fushave Pedagogët udhëheqës udhëheqin studentët në përzgjedhjen e literaturës, realizimit të punimit të diplomës, udhëzime specifike lidhur me punimin e prezantimin final të saj. Studentët që mbrojnë temë diplome përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare të dy viteve të para -Shtojca V 5 Miratimi i fushave të studimit në diplomim dhe i temave të diplomave -Shtojca II.11 Rregulloren e programit të studimit, seksioni 7 -Shtojca I.26. Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore shkencore FEF, Kreu VI, Neni 99 -Shtojca 3.2 Programi i provimit të formimit për programin e studimit bachelor në edukim fizik dhe sporte
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi final në UNIKO është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. <u>Rekomandohet që pesha të jetë 80% lëndë të kategorisë B dhe 20% lëndë të kategorisë C.</u> Pyetjet të jenë cilësore dhe forma e zgjidhjes së tyre me zhvillim e cila teston realisht nivelin e përgatitjes dhe formimit të studentit. Komisioni i Departamentit përgatit provimin përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar. Sekretaria mësimore e DE, afishon në stendat informuese në mjediset e FEF informacionet që lidhen me procesin (pedagogët udhëheqës, afatin e dorëzimit të punimit, datën dhe sallën e provimit, etj). -Shtojca 2.7 Udhëzues - punim diplome -Shtojca III.2 Programi i provimit të formimit për Programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte. -Shtojca III.9 Miratimi i Komisionit për provimin e formimit dhe për mbrojtjen e diplomës në përfundim të studimeve Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.	Nga shqyrtimi i dokumentave dhe evidencave GJV konstaton se në UNIKO për të fituar diplomën e studimeve Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” studentët, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t’i nënshtrohen edhe provës finale (provim formimi) apo ata me mesatare mbi 8 të dy viteve të para me mbrojtje diplome nëse e



Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	kërkojnë. Pedagogët japin udhëzime dhe bëjnë konsultime me studentët për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale. Secila palë mban përgjegjësitë që përfshihen në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të ciklit të studimeve bachelor. Komisioni që ngrihet për vlerësimin e studentëve në provimin final apo mbrojtjes së temës së diplomës të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", bazohet në rregulloren e departamentit, fakultetit, programit të studimit, në kërkesat, procedurat dhe standartet e diplomimit. Vlerësimi i temës së diplomës bëhet përmes një formulari të posaçëm i cili përmban mënyrën e paraqitjes së temës nga studenti, risitë që sjell në arsim, origjinaliteti i punimit, etj. Çdo zë përmban nga 5-25 pikë dhe vlerësimi minimal për të siguruar notë kaluese është 40 pikë, ndërsa vlerësimi maksimal është 100 pikë. -Shtojca III.4 Format i vlerësimit të punimit të diplomës, udhëheqës, oponent -Shtojca III.5 Model procesverbali për provimin e formimit
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Konstatohet se UNIKO ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme ndonëse temat e diplomave në bachelor janë kryesisht të karakterit teoriko empirik apo përmbledhje literature. Pedagogu udhëheqës mban kontakte të vazhdueshme me studentin diplomant gjatë javës dhe e asiston edhe në mjedise sportive për realizimin e pyetësorëve apo testeve ku në këtë rast një ndihmë e madhe është edhe koordinatori i programit të studimit. Institucioni mund të ndihmojë studentët, duke shpërndarë pyetësorët e tyre, tek studentët e tjerë në UNIKO nëpërmjet koordinatorëve ose me anë të pajisjes me një vërtetim zyrtar i mundëson studentit mbledhjen e të dhënave edhe jashtë UNIKO. Njësia bazë, pas marrjes së lejes nga DRAP mbështet studentët në kryerjen e testeve të ndryshme apo plotësimin e pyetësorëve nga nxënës dhe mësues në institucionet e arsimit parauniversitar në përputhje me fushën e tyre të studimit. Ndonëse ky program konsiderohet ende në fillimet e tij me jo më shumë se 5 vite. GVJ konstaton që <i>mungesa e laboratorëve të matjeve të cilësive fizike apo analizave biokimike në UNIKO nuk u krijon mundësi reale studentëve për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit.</i>
	-Shtojca I.33 Marrëveshja e bashkëpunimi midis FEF dhe DRAP për zhvillimin e praktikës profesionale

Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i vlerësimit të temës së diplomës përbëhet nga pedagogë ose specialistë të fushës. Ata duhet të jenë me tituj dhe grada. Për vlerësimin e diplomës anëtarët e komisionit të vlerësimit mbajnë parasysh disa kriterë si demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e temës së zgjedhur; përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumenteve të kërkimit; origjinalitetin e punimit; cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit); cilësinë e prezantimit etj. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Në vlerësimin e studentit merret parasysh vlerësimi i udhëheqësit të temës, i oponentit dhe komisionit, të cilët gjykojnë dobinë e punimit dhe zbatimin praktik të tij; cilësinë e prezantimit; përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve; si dhe arritjet akademike të studentit, gjatë ciklit të studimit. Rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Vlerësimi me notë, procedurat e dokumentimi janë të përcaktuara në aktet rregullatore të UNIKO, FEF. <i>-Shtojca I.26 Rregulloren e Brendshme të FEF, Kreu VI, neni 95</i> <i>-Shtojca II.11 Rregulloren e programit të studimit, kreu II seksioni 7</i> <i>-Shtojce III.5 Model procesverbali i provimit të formimit</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS dhe provimin final apo mbrojtjen e diplomës, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Deri në momentin e pajisjes me diplomë të të diplomuarve, UNIKO lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën dhe suplementin e diplomës sipas formateve të liçensuara dhe të aprovuara nga MAS në përputhje me aktet rregulluese dhe është regjistruar pranë QSHA. Vetë diploma firmoset nga Rektori dhe Dekani. Pajisja e studentit me diplomë është e përcaktuar në Rregulloren e Studimeve të UNIKO dhe konkretisht "studenti pas diplomimit pajiset me diplomën përkatëse shoqëruar me diplomën suplement". Gjithashtu, Sipas Rregulloreve të Programit të Studimit në përfundim të studimeve studentit pajiset me dokumentacionin e detyrueshëm që janë diploma dhe suplementi i diplomës, si edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Dorëzimi i diplomës bëhet në ceremoninë e

	diplomimit "Dita Akademike" të organizuar nga UNIKO. Të dhënat mbi diplomimin regjistrohen në Regjistrin e Lëshimit të Diplomave dhe Certifikatave, si dhe në Regjistrin bazë. -Shtojca 2.11 Rregullore e programit të studimit bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UNIKO arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet në dosje personale për një periudhë pa afat informacionit dhe paisjen e me informacionin që institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve dhe përpunon të dhëna statistikore sipas legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna janë të regjistruara dhe të ruajtura pranë sekretarive mësimore përkatëse e cila përbën regjistrin themeltar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të dhënat bazë i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore ndërsa për arkivim respektohen parashikimet ligjore të vendosura nga ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar". Gjithashtu, çdo institucioni tjetër që në formë ligjore drejton kërkesë pranë UNIKO, i vihen në dispozicion të dhënat e mësipërme, gjithmonë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. -Shtojca I.9. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, rruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, Neni 5 dhe 6			
Konkluzione	GVJ e gjen Standardin III.5 të plotësuar përgjithësisht por mungesa e laboratoreve të matjeve të cilësive fizike apo analizave biokimike në UNIKO e cila nuk u krijon mundësi reale studentëve por edhe pedagogëve për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e kolegjit. Pikërisht kjo pamundësi e lë në ngërç kërkimin shkencor bazuar e mbështetur në studime të mirëfillta laboratorike. Kjo na çon në konkluzionin që ky standard përmbushet kryesisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Departamenti i Edukimit është njësi kryesore përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, përbëhet kryesisht nga stafi i këtij departamenti. Në varësi të fokusit të lëndëve specifike, për mësimdhënie përfshihet gjithashtu personel akademik nga departamente të tjera. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, ky program i ciklit të parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, është mbuluar në mënyrë të qëndrueshme nga një staf akademik i organizuar. Stafi i angazhuar në këtë program studimi (<i>sipas tabelës 6 te aneks tabelat përmbledhëse</i>), për tre vitet akademike është si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>6</td><td>0</td><td>9</td><td>0</td><td>7</td><td>0</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>5</td><td>10</td><td>5</td><td>8</td><td>7</td><td>6</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>12</td><td>10</td><td>15</td><td>8</td><td>16</td><td>6</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1	0	1	0	1	0	Prof. Asoc.	0	0	0	0	1	0	Dr/Phd	6	0	9	0	7	0	Msc.	5	10	5	8	7	6	Gjithsej	12	10	15	8	16	6
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	1	0	1	0	1	0																																											
Prof. Asoc.	0	0	0	0	1	0																																											
Dr/Phd	6	0	9	0	7	0																																											
Msc.	5	10	5	8	7	6																																											
Gjithsej	12	10	15	8	16	6																																											
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën	Nga verifikimi i të dhënave statistikore të aneks tabelave përmbledhëse, rezulton se në vitin akademik aktual, për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik																																																

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43422

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

dhe Sporte”, personeli akademik me kohë të plotë zë pjesën më të madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie (74%). Stafi akademik (me kohë të plotë) që mbulon modulet e programit të studimit për vitin akademik 2023-2024 ka shkallë kualifikimi. 58.9% e tij zotëron tituj dhe grada shkencore. Ndërkohë, 17.6% e stafit është në proces doktorature dhe 23.5% e stafit është në proces aplikimi për regjistrimin në shkollë doktorale.

Ngarkesa e orëve mësimore, për stafin e angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet akademike (referuar tabelës 12 te aneks tabelat përmbledhëse), është si më poshtë:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2022-2023	1500	1200	300	80% / 20%
2023-2024	1500	925	575	62% / 38%
2024-2025	1350	950	400	70% / 30%

Bazuar në këtë analizë, raportin e numrit të PAE dhe PAK, përmbushin kërkesat rregullatore për mbulimin e të paktën 70% të ngarkesës mësimore nga stafi akademik PAE. Vetëm viti akademik 2023-2024 nuk përmbush kriterin ligjor duke qe se stafi PAE e mbulon në masën 62%, por qe kjo është rregulluan në vitin pasardhës.

Shtojca 4.1 Tabela përmbledhëse për programin e studimit (tabela 12.1, 12.2, 12.3.)

Shtojca 1.28 Të dhëna për personelin akademik që mbulon disiplinat e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte

Shtojca IV.1 Tabela 7-Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre

Shtojca II.19 Cv Stafi Akademik, Programi i Studimit Bachelor në “Edukim Fizik Dhe Sporte”

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për

Sipas të dhënave të dokumentacionit të paraqitura nga institucioni për akreditimin e programit, vihet re se gjatë viteve të fundit nuk ka munguar qëndrueshmëria e personelit akademik të angazhuar në këtë program. Nga verifikimet e kryera nga GJV pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, u konstatua se PAE dhe PAK janë të punësuar në bazë të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	kontratave të punës, të cilat përfshijnë detyrimet e ndërsjella për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. <i>Shtojca IV.6 Modeli Kontratës individuale për kategoritë e personelit akademik</i> <i>Shtojca II.16- Programet lëndore të mbuluara nga personeli akademik</i> <i>Shtojca IV.18 Model formulari i orëve në auditor</i> <i>Shtojca IV.1 Tabela 2, Të dhënat përmbledhëse të personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Departamentit të Edukimit përgjegjës për programin e studimit</i> <i>Shtojca 1.4 Rregullore e drejtorise Juridike dhe Burimeve Njerëzore, neni 7 pika 8</i> <i>Shtojca 1.13 Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura e rekrutimit për stafin akademik dhe ndihmës në UNIKO bazohet në rregulloren e universitetit dhe udhëzimet specifike në nivel institucional dhe në njësitë kryesore. Këto procedura janë përfshirë në Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore, ku përshkruhen hapat për rekrutimin e personelit akademik. Stafi akademik për programin e ciklit të parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, është përzgjedhur sipas procedurave të parashikuara në kuadrin rregullator të lartpërmendur dhe në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë në RSH. Departamenti përgjegjës identifikon nevojat për staf akademik bazuar në ngarkesën mësimore dhe numrin e studentëve të planifikuar, përgatit kriteret e rekrutimit dhe pasi miratohen nga Fakulteti, ato publikohen në faqen e internetit të institucionit dhe në mediat audiovizive dhe të shkruara. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një komision, i cili përbëhet nga përfaqësues të Rektoratit, Fakultetit, Departamentit dhe nga titullari i lëndës përkatëse. Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek çdo hap të procesit të rekrutimit dhe të monitorimit të progresit të stafit, duke siguruar transparencë dhe përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale. Në dy dosje të përzgjedhura rastësisht gjatë vizitës në institucion u konstatua se dokumentacioni përkatës përfshin: kontratën e punës, diplomat dhe listat e notave të noterizuara për studimet universitare, masterin dhe doktoratën, CV-në, si dhe të dhëna mbi kualifikimet dhe pjesëmarrjen në aktivitete kërkimore dhe akademike brenda dhe jashtë vendit. <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i> <i>Shtojca 1.3 . Rregullore e UNIKO neni 2</i> <i>Shtojca 1.4.Rregullore e brendshme e Universitetit Luarasi nr. 16 02 2019</i> <i>Shtojca 1.4 Rregullore e drejtorise Juridike dhe Burimeve</i>

	<i>Njerëzore, nenni 7 pika 8</i> <i>Shtojca 1.13 Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik</i> <i>Shtojca IV.7 dhe në faqen web të UNIKO</i> <i>Shtojca IV.8 Format i Vendimit të Rektorit për emërimin e Stafit Akademik</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Departamenti i Edukimit, përgjegjës për këtë program studimi, ka në strukturën e tij edhe punonjës ndihmës akademikë të angazhuar për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor. Personel ndihmës-akademik me karakter mësimor është, sekretarja e departamentit dhe personel ndihmës-akademik me karakter administrativ, punonjësi i bibliotekës dhe asistentja e dekanit. Po ashtu, në laboratorë dhe mjedise të tjera të disponueshme për studentët, janë të angazhuar edhe personel ndihmës akademik, i cili kontribuon në zhvillimin efikas të procesit mësimor, në varësi të nevojave të tij. Këtë e konfirmoi gjithashtu GVJ gjatë vizitës në institucion. <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i> <i>Shtojca II. 10 Rregullore e brendshme e Departamentit të Edukimit</i> <i>Shtojca 1.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore shkencore fakulteti I Edukimit dhe Fiziologjisë</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për aplikim dhe nga verifikimi i kryer nga GVJ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, rezulton se ekziston një praktikë e plotë për përditësimin e të dhënave për personelin akademik të angazhuar në këtë program. Në dosjet e shqyrtuara rastësisht nga GVJ, vërehet se informacioni mbi stafin akademik dhe atë ndihmës përditësohet çdo vit, duke u organizuar në forma standardizuara të dosjeve personale në përputhje me rregulloren përkatëse. <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i> <i>Shtojca IV.10 Procesverbal i komisionit të vlerësimit të dosjeve të kandidatëve të paraqitura për vendin e punës personal akademik me kohe të plotë dhe kohë të pjesshme</i> <i>Shtojca 1.13 Vendimi i Rektorit të UNIKO nr. 674 "Për disa ndryshime" në udhëzimin e Rektorit "Për vlerësimin e kandidatëve që punësohen si personal akademik"</i> <i>Shtojca 1.4 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e drejtorisë juridike dhe burimeve njerësore</i> <i>Shtojca 1.9 Rregullore e UNIKO për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Shtojca 1.14 Udhëzime për përmbajtjen e dosjes së stafit</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>akademik, ndihmës akademik dhe administrativ</i> Shtojca IV.3 Marrëveshja e organizimit të kohës vjetore të pune Shtojca IV.18 Formulari i ngarkesës për orët brenda dhe jashtë auditorit , Shtojca II.16 Programet lëndore Shtojca II.16 Rregjistri i pedagogut
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Universiteti UNIKO ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me UNIKO, FEF dhe Departamenti i Edukimit kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike për të mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të ndryshme në institucione arsimore publik. Stafi akademik që mbulon këtë program është aktiv në monitorimin e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve. Implementimi i praktikës profesionale, si një komponent i rëndësishëm i programit të studimit, mbështetet në udhëzuesin përkatës të hartuar nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin dhe studentët e programit, GVJ vërejtë se përgjegjësi i departamentit përcakton edhe koordinatorin përgjegjës për procesin e kryerjes së praktikës profesionale. Drejtuesi i njësisë kryesore lidh marrëveshje bashkëpunimi me DRAP deri një muaj para fillimit të praktikës. Praktika profesionale zhvillohet në shkollat 9- vjeçare të Qarkut të Korçës, nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. Shtojca II.6 Udhëzuesi i praktikës Shtojca II.10 Rregullore e Brendshme e Departamentit të Edukimit neni 21, pika 9 Shtojca II. 6- Udhëzuesi i praktikës së programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” Shtojca II.10 Rregullore e Brendshme e Departamentit të Edukimit neni 21, pika 9
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Gjatë takimeve me stafin e programit të ciklit të parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, dhe studentët, u vu re roli i pedagogëve dhe Personeli mbikqyrës në monitorimin e praktikës profesionale, si dhe në asistencën e ofruar për hartimin e raportit që studenti dorëzon pas përfundimit të këtij procesi. Shtojca II.6 Udhëzuesi i praktikës
Konkluzione	Departamenti i Edukimit ka staf ndihmës për të mbështetur

	procesin mësimor, ndërsa universiteti ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike për të siguruar praktika profesionale për studentët. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, GVJ konstaton se numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program ka qenë i qëndrueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Duke iu referuar dokumentacionit të aplikimit dhe vizitës në institucion për infrastrukturën e UNIKO, veçanërisht në njësinë kryesore Fakultetin të FEF dhe Departamentin të Edukimit, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare të përshtatshme për realizimin e suksesshëm të programit. Gjithashtu, ka ambiente mbështetëse për lëndët e praktikave dhe hapësira për stafin akademik dhe ndihmës, që shërbejnë për studentët. Ambientet mbështetëse, si ato për Burimet Njerëzore, Financa dhe Biblioteka, janë të akomoduar në një godinë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin normal të aktiviteteve të tyre. <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitave në institucion, u vërejt se ambientet janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Edikim Fizik dhe Sporte". Këto ambiente përfshijnë salla leksionesh, zyra dhe laboratore. Fakulteti i FEF dhe Departamenti i Edukimit disponojnë hapësira të nevojshme për të garantuar një realizim të suksesshëm të programit. Fakulteti i Ekonomisë ofron ambiente që plotësojnë të gjitha kriteret teknike dhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, siç është përcaktuar në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", sipas të cilit kërkohet një sipërfaqe prej 2.5 m ² për student, ndërsa institucioni ka një tregues prej 4.575 m ² për student. Në këto ambiente është instaluar shërbimi Office 365,

	që mundëson përdorimin e aplikacioneve Microsoft Office. Godina ofron akses është plotësisht e mbuluar me Wi-Fi. Institucioni gjithashtu ofron një sistem online për vlerësimin e pedagogëve në fund të çdo semestri dhe një platformë e-learning, ku studentët mund të kenë akses në materialet mësimore, njoftimet e pedagogëve dhe komunikime të tjera. UNIKO zotëron një sistem automatik për ruajtjen e të dhënave të studentëve, që shërben si një bazë e rëndësishme të dhënash. Gjithashtu UNIKO së fundmi ka implementuar edhe platformën “Pitagora” nga RASH. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për mbështetje të procesit mësimor dhe aktiviteteve shkencore, institucioni disponon një laborator të teknologjisë së informacionit për studentët e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, i cili është i pajisur me kompjutera dhe me video projektor me qëllim përmbushjen e kërkesave sipas moduleve përkatëse. Në funksion të studentëve për të realizuar praktikat sportive në module të ndryshme janë në përdorim të gjitha mjediset e Qendrës Sportive, Korçë si: stadiumi, fushat e tenisit, mjediset e brendshme (salla) dhe të jashtme të lojërave me dorë, Pallati i Sportit “Tamara Nikolla”, anekset e tjera të futbollit si dhe palestra e shkollës “Pandeli Cale”. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion Shtojcën IV.12 Të dhëna për kapacitetet infrastrukturore të UNIKO dhe FEF Shtojca I.32-Marrëveshje bashkëpunimi midis FEF, Universiteteve, Institucioneve të tjera dhe biznesit Shtojca IV.21 Procesverbal marrjeje në dorëzim i bazën materiale të Programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programet e instaluar në kompjuterët e laboratorëve janë moderne dhe përfshijnë, përveç aplikacioneve bazë, edhe software të specializuar që lidhen me lëndët e këtij programi. Për realizimin të moduleve të veçanta, studentët shfrytëzojnë laboratorët e teknologjisë së informacionit pranë UNIKO, në varësi të specifikave të moduleve të programit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion Shtojca IV.12 Shtojcën IV.12 Të dhëna për kapacitetet infrastrukturore të UNIKO dhe FEF
Konkluzione	GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e siguruar nga institucioni dhe vizitën e kryer, arrin në përfundimin se mjediset mësimore dhe infrastruktura të cilat mbështesin

	zhvillimin e programit janë të përshtatshme për një funksionim normal të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Duke u mbështetur në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni dhe në vizitën e GVJ në ambientet e bibliotekës së UNIKO, evidentojmë se për modulet dhe lëndët e programit, studentëve i'u ofrohen literaturë bazë dhe ndihmëse, e cila është e përcaktuar në syllabuset përkatëse, si në format fizike ashtu edhe digjitale. Biblioteka ofron informacione on-line nga burime të ndryshme elektronike një ndër to është EIFL (Electronic Information for Library). Megjithatë, mendojmë se numri i titujve të librave në shqip dhe në gjuhë të huaj të lidhur me këtë program duhet të rritet, përfshirë titujt e viteve të fundit, me qëllim që të pasurohet më tej fondi i bibliotekës. Shtojca IV.13 Të dhëna mbi fondin e bibliotekës të UNIKO dhe FEF Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Duke u mbështetur në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni dhe në vizitën e GVJ pranë bibliotekës, konstatojmë se për disa module të këtij programi mungon literatura në shqip. Gjithashtu mungonin edhe cikle leksionesh të shkruara nga titullari referoju edhe Standardit III .1 kriteri 2 si më sipër detajuar. Sipas evidencave dhe nga vizita në UNIKO, u vërejt se është bërë kërkesë për të pasuruar fondin e bibliotekës me disa tekste bashkëkohore që përdoren në këtë program. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion Shtojca I.14 Udhëzim për përmbajtjen e dosjes së stafit
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Në bazë të dokumentacionit dhe vizitën në FEF të UNIKO, u vërejt se studentët e programit kanë akses në Bibliotekën Mësimore, e cila ndodhet në godinën ku zhvillohet mësimi. Në ambientet e kësaj bibliotekë, studentët kanë mundësi të barabarta për të shfrytëzuar shërbimet, për të studiuar dhe për

barabartë nga studentët e programit të studimit.	të aksesuar literaturën e ofruar. Orari dhe shërbimi janë të adaptuara për të përmbushur nevojat e studentëve, duke qenë se mjediset e bibliotekës janë të hapura nga e hëna deri në të premte. Megjithatë, mendojmë se ambientet për studim duhet të jenë më të bollshme për studentët. Biblioteka ofron gjithashtu mundësinë e kërkimit dhe gjetjes së librave online në sallën e leximit. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në institucion, u vërejt se biblioteka është relativisht e pajisur me literaturë fizike në shqip, e cila përfshin tekste mësimore, libra, revista periodike, buletine të institucioneve përse i përket programit të studimit në ciklin e parë Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte". Shërbimi në bibliotekë ofrohet nga punonjës të caktuar. Siç është theksuar më parë, është e nevojshme që ky fond literature të pasurohet më tej me literatura bashkëkohore. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Shërbimet aktuale të bibliotekës ofrojnë akses të barabartë për të gjithë përdoruesit potencialë, përfshirë studentët dhe stafin akademik, pa kosto, pasi ata mund të anëtarësohen. Përveç kësaj, biblioteka ofron shërbimin online përmes një platforme digjitale të menaxhimit të librave, e cila u mundëson përdoruesve të aksesojnë baza të dhënash dhe informacion të dobishëm në fushën e ekonomisë, për t'i analizuar dhe përdorur në punimet e tyre kërkimore shkencore. UNIKO është anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare e mundëson EIFL (Electronic Information for Library), ku studentët kanë mundësi ta aksesojnë jo vetëm nga salla e bibliotekës por edhe online. Shtojca I.36- Lista e librave të dhuruara bibliotekës FEF Shtojca IV.22 Lista e librave që mund të përdoret nga studentët e Programit të studimit "Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte"
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë	Biblioteka ka në dispozicion një program kompjuterik për gjetjen e titujve të librave. Megjithatë, në ambientet e bibliotekës nuk u gjetën pajisjet kompjuterike që studentët mund të përdorin. Fondi i bibliotekës është informatizuar, duke e bërë më të lehtë gjetjen e literaturës përkatëse. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion

studentët.	<i>Shtojca IV.13 Të dhëna mbi fondin e përgjithshëm të bibliotekës së UNIKO dhe FEF</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka operon nga ora 08:30 deri në 16:00, duke ofruar shërbime për studentët e të gjitha programeve. Gjatë sezonit të provimeve, sipas edhe të RVB-së, kjo bibliotekë ofron orar të zgjatur në përputhje me nevojat e studentëve dhe kapaciteteve të tyre. <i>Raporti i vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e aplikimit për akreditim dhe vizitën në UNIKO, vëren një komunikim institucional në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Në lidhje me evidentimin tonë për mungesat në literaturën bashkëkohore të programit, drejtuesi i Departamentit të Edukimit bazuar edhe në evidencat, kishte bërë kërkesën e për të pasuruar këtë fond, si për materialet fizike ashtu edhe për ato online. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, arrin në përfundimin se institucioni disponon ambiente të veçanta për studim dhe një bibliotekë me një fond literaturë relativisht të pasur që mbështet procesin e mësimdhënies për stafin dhe studentët. Stafi akademik dhe studentët kanë akses në bibliotekën dixhitale përmes disa platformave online, për të cilat institucioni ka lidhur kontrata shërbimi. Bazuar në syllabuset e lëndëve të programit, institucioni duhet të pasurojë më tej fondin e bibliotekës me literaturë më të fundit, përfshirë edhe materiale në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktiviteteve akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Administrimi i informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetet e tyre realizohet nga njësitë kryesore të UNIKO, përmes sekretarisë mësimore, zyrës së rekrutimit dhe pranimi, si dhe zyrës së karrierës. Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, UNIKO ka nënshkruar marrëveshjen me RASH për sistemin elektronik Pitagora. Sistemi Pitagora administrojnë të gjithë dokumentacionin që lidhet me aktivitetin e studentëve, GVJ zhvilloi takime dhe monitorime pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të FEF, ku evidentoi administrimin e informacionit për studentët, duke filluar nga faza e regjistrimit dhe deri në procesin e diplomimit. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Shtojca 1.6 Marrëveshja e RASH për mirëmbajtjen e sistemit Pitagora</i> <i>Shtojca IV.11 Format i regjistrimit të pedagogut</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit për personelin akademik dhe ndihmës realizohet përmes sistemit elektronik "Pitagora", e cila ofron të dhëna regjistrimi i studentëve në programet e studimit, transferimi i tyre, faturimet, pagesat, menaxhimi i mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave dhe baza e të dhënave të diplomimit. Sistemi Pitagora administrojnë dokumentacionin e hartuar nga pedagogu në lidhje me vlerësimin e studentëve <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që	Sistemi Elektronik Pitagora përditësohet me të gjithë informacionin që mbulon procesin e regjistrimit, zhvillimin e programit dhe diplomimin e studentëve, duke mundësuar

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	bashkërendimin e informacionit mes pedagogëve dhe studentëve. Ky sistem përfshin përmbajtjen e programit, procesin e mësimdhënies, materialet didaktike të ofruara nga pedagogët, detyrat e kursit, si dhe vlerësimin e pedagogëve dhe procesit mësimor. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion Shtojca IV.9 Urdhër nr 03, datë 07.01.202 5për ngritjen e grupit të monitorimit të procesit mësimor, zhvillimit të praktikave dhe sezonit të provimeve për vitin akademik 2024-2025 Shtojca I. 9 Rregullore për mbrojtjen ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave Shtojca 1.6.1 Manual mbi përdorimin e Sistemit Elektronik Pitagora			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit, që përfshin të gjitha platformat dhe mjetet e përmendura, mundëson monitorimin dhe shpërndarjen në kohë reale të informacionit mbi veprimtaritë administrative dhe akademike të institucionit. Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Sipas konstatimeve të GVJ-së, faqja e internetit e UNIKO përmban informacion mbi programin e studimit, stafin, si dhe njoftime lidhur me datat e provimeve, oraret e studimeve dhe mundësitë e punësimit. Institucioni përditëson rregullisht faqen e tij të internetit dhe platformat e rrjeteve sociale për të siguruar komunikim të vazhdueshëm me publikun.			
Konkluzione	GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe në vizitën e realizuar në ambientet e tij, konkludon se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit për administrimin dhe monitorimin e veprimtarisë akademike përmbush standardet në mbështetje të procesit mësimor, stafit akademik dhe studentëve të programit. Në sekretarinë mësimore nuk u vunë re parregullsi në mbajtjen e procesverbaleve dhe as parregullsi në regjistrin themeltar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në dokumentet e paraqitura nga institucioni përfshihen Relacioni për Planifikimin e Buxhetit Vjetor, Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditit të Pavarur. Dokumentacioni tregon se burimet financiare të institucionit përbëhen kryesisht nga tarifat e studimeve, ndërsa pjesa e mbetur përfshin donacione dhe të ardhura nga aktivitete të tjera. Sipas dokumentacionit, institucioni demonstroi qëndrueshmëri financiare, duke operuar me fitim dhe duke garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të programeve nga këndvështrimi financiar. <i>Shtojca IV.15 Të dhëna lidhur me kosto/student për 3 vitet e fundit</i> <i>Shtojca IV.16 Të dhëna lidhur me fondet e UNIKO "grant i buxhetit"; "të ardhurat e krijuara" në vitet 2022;2023;2024.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni pas buxhetit që akordohet nga MAS dhe buxhetin nga të ardhurat e universitetit, harton planin financiar projektbuxhetin të ndarë sipas strukturës që i përshatet zërave të ndryshëm të financimit të tillë si: financimin e burimeve njerëzore (paga, shpërblime), shpenzime operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe mjediseve (rikonstruksion i godinës), shpenzime për pasurimin e literaturës dhe bazës materiale të nevojshme në funksion të programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" dhe burimet për financim që janë "grantet i buxhetit të shtetit" dhe "të ardhura të krijuara nga institucioni harton relacionin për planifikimin e buxhetit i cili miratohet nga senati dhe bordi i administrimit. Ky dokumentacion nuk përpilohet në nivelin e njësisë bazë (departamentit) që mbulon programin përkatës. Të dhënat mbi tarifat, kostot për student, të ardhurat etj., janë të përmbledhura në nivel institucional për të gjithë studentët e UNIKO. <i>Shtojca IV.16 Të dhënat mbi fondet e UNIKO "Grant i Buxhetit" dhe "Të ardhurat e krijuara për 3 vite</i> <i>Shtojca I.8.1 rregullore financiare dhe e shpërndarjes së të ardhurave UNIKO</i> <i>Shtojca I.20 Rregullore e Bordit të administrimit, neni 2</i> <i>Shtojca IV.17 Të ardhurat dhe financimet e UNIKO në vitet 2022;2023;2024</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen	UNIKO si çdo institucion publik, UNIKO e realizon këtë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	veprimtari në respekt të ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe se çdo vit dorëzon pranë MAS dhe Degës së Thesarit Korçë pasqyrat financiare vjetore të çdo viti. UNIKO i nënshtrohet auditimit financiar që realizohet nga Auditi i Brendshëm i MAS duke u bazuar në përcaktimet e bëra në dokumentat e brendshëm si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Rezultatet e auditit financiar janë bërë publike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga UNIKO në faqen zyrtare të web-it. Rezultatet e auditit gjenden në http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/transparenca/auditim_0.pdf			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ evidentoi raportim të realizimit të buxhetit deri në nivelin e njësisë bazë lidhur me aspekte financiare për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Raporti i veprimtarisë financiare, diskutohej me organet kolegjiale të Universitetit, si në Rektorat, Bordin e Administrimit (BA) dhe në Senatin Akademik.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Sipas dokumentacionit financiar të UNIKO, institucioni ka treguar një qëndrueshmëri financiare gjatë tre viteve të fundit. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e numrit të studentëve mund të paraqesë një qëndrueshmëri financiare të programit në të ardhmen. Institucioni ka dëshmuar ndër vite se të ardhurat e tij janë jo të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe për të gjeneruar fitim. <i>Shtojca I.8.1 rregullore financiare dhe e shpërndarjes së të ardhurave UNIKO</i>			
Konkluzione	GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar në UNIKO, konkludon se institucioni demonstroi qëndrueshmëri financiare, duke siguruar fonde dhe mbështetje të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor e kërkimor dhe, rrjedhimisht, për funksionimin e suksesshëm të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka përcaktuar politika dhe procedura të qarta për procesin e regjistrimit të studentëve, realizimin e programeve të studimit dhe diplomimin e tyre. Për këtë qëllim, janë miratuar një sërë aktesh rregullative. Statutin e UNIKO, Kreu VI, nenet 51, 66, 68, neni 70 janë të përcaktuara qartë të gjitha procedurat që lidhen me programet e studimit të ciklit të parë, shpalljen e kriterëve, dokumentacionin, rastet e transferimit të studimeve, etj. Në zbatim të statutit të UNIKO-së, janë hartuar edhe katër rregullore specifike: 1. Rregullorja e Universitetit; 2. Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore shkencore, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë; 3. Rregulloren e e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte". Këto akte nënligjore dhe rregullative përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat që përcjellin ecurinë e studentit nga regjistrimi deri në përfundim të programit. Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore shkencore FEF Shtojca I.26 Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore shkencore, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë Shtojca I.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë Kreu VI, nenet 51, 66, 68, neni 70
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton, nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat e zbatuara gjatë gjithë ciklit të studimeve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat mbështesin studentët në çdo hap të përparimit të tyre përgjatë programit të ciklit të parë të studimeve në

	"Edukim Fizik dhe Sporte". Shtojca 1.26 Rregullore e FEF
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në përputhje me kuadrin rregullator të përmendur më sipër, GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për regjistrim në këtë program janë të përcaktuara qartë. Institucioni përcakton kriteret e pranimiit dhe kuotat bazuar në kapacitetet pritëse të UNIKO. Sipas rregullores së UNIKO, Departamenti i FEF, i cili mbulon këtë program, propozon kriteret e pranimiit, të cilat miratohen nga Dekani dhe më pas nga Senati Akademik. Në periudhën e përcaktuar nga MAS, UNIKO organizon takime informuese me maturantët përmes grupeve të pedagogëve dhe stafit administrativ. Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO Shtojca 1.26 Rregulloren e FEF Shtojca 1.1 Statuti UNIKO Shtojca 1.1 Statutin e UNIKO, Kreu VI, neni 55
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimiit përgjatë kursit të studimit, të transferimiit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimiit të dijeve dhe të diplomimiit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedura e pranimiit për studentët e ciklit të parë në programin "Edukim Fizik dhe Sporte" është e qartë dhe transparente. Studentët janë të detyruar të njohin këto kritere, të cilat janë të thjeshta, të kuptueshme dhe të lehta për t'u ndjekur nga kushdo i interesuar. Po ashtu, kriteret dhe procedurat e regjistrimiit dhe transferimiit janë të qarta dhe të kuptueshme. Të gjitha këto informacione janë bërë publike dhe janë të aksesueshme në faqen e internetit të universitetit. Departamenti i Edukimit diskuton dhe propozon, për çdo vit akademik, kriteret të veçanta të pranimiit dhe versioni përfundimtar i tyre miratohet nga Senati i UNIKO Në përcaktimin e kriterëve të veçanta të pranimiit, departamenti gjykon, plotësimin e kushteve shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore të miratuar, e cila publikohet në faqen zyrtare të UNIKO, realizimi i testi praktik dhe vlerësimi me pikë i kandidatëve, testi praktik dhe pikët përkatëse sipas rezultatiit janë të publikuara në faqen e UNIKO; raporti midis konkurrimiit praktik dhe notës mesatare të shkollës së mesme (sipas VKM-së), i përcaktuar me vendim Departamenti dhe i miratuar nga Senati Akademik. Ky raport për vitet akademike 2022-2023, 2023-2024, dhe 2024-2025 është 40% sipas mesatares dhe 60% nga testi praktik.
	Shtojca 1.26 Rregullore e organizimiit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore FEF, Kreu V, neni 46 Kriteret e pranimiit për çdo program studimi https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimiit-2/

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti dhe fakulteti kanë politika të përgjithshme për rekrutimin, si dhe politika specifike për pranimin e studentëve për çdo program studimi dhe çdo vit akademik. Këto politika, të përcaktuara në statutin e UNIKO, mund të pësojnë ndryshime me kalimin e viteve. Kriteret hartohen në fillim të çdo viti akademik dhe informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për studimet dhe pranimin është bërë publik në faqen e internetit të universitetit: www.unkorce.edu.al Shtojca I.26 Rregullorja e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore e Shkencore e FEF Shtojca II.11 Rregullorja e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni përgatit dhe publikon, para fillimit të vitit akademik, kriteret specifike për kandidatët me aftësi të veçanta ose për ata nga grupe të pakicave. Për çdo program studimi që ofrohet nga FEF, përfshi edhe programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, parashikohen kuota të dedikuara për kandidatë me aftësi të veçanta, nga pakica dhe shtresa të marginalizuara.			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadrin rregullativ të UNIKO-së, të përmendur edhe më sipër, nenet dhe kriteret për pranimin përcaktojnë gjithashtu kriteret specifike për kandidatët nga vende të tjera. Shtojca I.2 Rregullorja e UNIKO Shtojca I.26 Rregulloren e FEF Shtojca I.1 Statuti UNIKO			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Gjatë vizitës së GJVJ në institucion, si dhe në shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës, u evidentuan raste mbështetjeje financiare për studentët e ciklit të parë Bachelor në rang universiteti. Shtojca V.4 Njoftim për përfitimin e bursave Shtojca V.4 Njoftim për përfitimin e bursave			
Konkluzione	<i>GJVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga institucioni dhe vizitës në UNIKO, konkludon se institucioni ka procedurë të plotë për pranimin, regjistrimin dhe transferimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X



Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it të UNIKO, si dhe nga takimet me studentët dhe stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion, vërejmë se studentët e regjistruar në këtë program kanë akses në informacion të plotë lidhur me ecurinë dhe progresin e tyre akademik përmes disa kanaleve komunikimi. Informacionin e përgjithshëm, studentët e marrin përmes faqes së internetit të https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09 , rrjete sociale dhe në linkun https://unkorce.edu.al/studentet-pyesin/ ku përditësohen njoftimet dhe informacionet më të fundit, përfshirë orarin mësimor, grafikun e provimeve dhe datat e eventeve të tjera. Një informacion më specifik për modulët e programit u ofrohet studentëve në fillim të çdo lënde, përmes seminarit udhëzues që zhvillohet javën e parë të mësimit, ku ata njoftohen me syllabusin e modulit, literaturën e nevojshme dhe format e vlerësimit. Një kanal tjetër komunikimi është përdorimi i adresave elektronike të pedagogëve dhe studentëve, të cilat mund të jenë individuale ose adresa të grupeve mësimore, ku ata informohen mbi vlerësimet dhe njoftimet për reklamime.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Universiteti dhe fakulteti informojnë rregullisht studentët mbi kriteret për njohjen e nivelit të studimeve të mëparshme, përfshirë llojin e shkollave dhe nivelin e plotë ose të pjesshëm të studimeve. UNIKO pranon transferime studimesh nga degë, fakultete ose universitete të tjera, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, me kushtin që të plotësohen kreditet e parashikuara në ligjin për arsimin e lartë, rregulloren e shkollës dhe statutin e universitetit. <i>Shtojca I.26 Rregullorja e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore e Shkencore e FEF</i> <i>Shtojca II.11 Rregullorja e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e	Universiteti dhe fakulteti informojnë rregullisht studentët mbi kriteret për njohjen e nivelit të studimeve të mëparshme, përfshirë llojin e shkollave dhe nivelin e plotë ose të pjesshëm të studimeve. UNIKO pranon transferime studimesh nga degë, fakultete ose universitete të tjera, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, me kushtin që të plotësohen kreditet e parashikuara

studimit.	në ligjin për arsimin e lartë, rregulloren e shkollës dhe statutin e universitetit. Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore shkencore FEF neni 105 Shtojca I. 37 Procedura e ekuivalentimit për transferimin e studentëve			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Përveç kuadrit rregullator të përmendur më sipër, i cili përfshin përcaktime për provimin përfundimtar të përgjithshëm dhe procedurat për përgatitjen e diplomës, një rol të rëndësishëm luan edhe informimi i studentëve. Nga takimi me studentët e këtij programi, u konfirmua se ata ishin njohur me kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës, si dhe për provimin përfundimtar të përgjithshëm, në fillim të semestrit të parë të vitit të tretë. Shtojca III.2 Programi i provimit të formimit për Programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” Shtojca II.11-Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përveç takimeve që stafi akademik zhvillon me shkollat e mesme gjatë procesit të ofertës akademike, studentët marrin informacion të plotë që në fazën e aplikimit dhe më tej, përmes takimeve pranë zyrës së informacionit, sekretarisë mësimore, udhëzuesve të studentëve, faqes së internetit të institucionit, dhe burimeve të tjera. Nga takimi me stafin akademik, u evidentua gjithashtu roli i Departamentit të Edukimit në informimin e kandidatëve potencialë për regjistrim në këtë program, duke përfshirë studentët në përfundim të programit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion.			
Konkluzione	GVJ konstaton se UNIKO disponon dokumentacion të plotë për informimin e studentëve mbi kriteret e pranimit, detyrimet e tyre në lidhje me programin e studimit, rregullat dhe afatet e përmbushjes së detyrimeve, mbrojtjen e provimit përfundimtar, si dhe kriteret për pranimin dhe transferimin e studimeve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni si para ashtu edhe gjatë periudhës së regjistrimeve, ofron informacion të rëndësishëm për studentët kandidatë dhe ata që regjistrohen, duke i njohur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Në UNIKO zhvillohet edhe java e orjentimit për studentët e rregjistruar rishtaz. Nga vizitat në mjediset e UNIKO, takimet dhe kontaktet me studentët, si dhe nga dokumentacioni mbështetës i RVB-së, konkludohet se studentët janë të informuar dhe me detaje mbi strukturën e programit të studimeve, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, përfshirë limitet dhe hapësirat e lejuara. Për realizimin e këtij objekti janë përdorur forma të ndryshme informimi, si java e orientimit dhe mirëseardhjes, vizitat gjatë ditëve të regjistrimit, takimet informuese dhe sqaruese, të cilat i mbështesin studentët në marrjen e vendimit përfundimtar për regjistrim. <i>Shtojca II.18. Kalendar për ditët e informimit të maturanëve</i> <i>Shtojca III.2 Programi i provimit të formimit për Programin e studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në Rregulloren e programit të ciklit të parë në Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", përveç informacioneve të tjera të dobishme, është paraqitur edhe programi mësimor, i ndarë sipas lëndëve/moduleve, me ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë tij. Gjithashtu, studentët njihen me përmbajtjen e programit për secilën lëndë që në fillim të procesit mësimor. <i>Shtojca II.11-Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Studentët janë të mirëinformuar për mundësitë e punësimit që në fillim dhe gjatë gjithë kohës së studimeve. Nga takimi me ta, u evidentua se studentët janë në dijeni për marrëdhëniet e bashkëpunimit që institucioni ka me aktorë të biznesit në vend. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, si dhe Zyra Alumni, duke ofruar informacion të vlefshëm për mundësitë e tyre të punësimit në të ardhmen. <i>Shtojca II.17 Rezultatet e studimeve të tregut</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të	Studentët kanë akses të plotë për marrjen e informacionit, si përmes të gjitha kanaleve të komunikimit elektronik të përmendura më sipër, ashtu edhe nëpërmjet kontakteve direkte me stafin akademik të programit, drejtuesit e njësisë kryesore, Zyrën e Karrierës dhe sekretarinë mësimore. https://unkorce.edu.al/ <i>Shtojca I.6 Mrrëveshja me RASH për sistemin elektronik</i>

realizimit të tij.	PITAGORA Shtojca I.6.1 Manuali i sistemit elektronik PITAGORA Shtojca I.6.1 Marrëveshja me RASH për sistemin PITAGORA			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i informacionit, me të gjitha format e analizuara më lart, është i aksesueshëm edhe për studentët në distancë. Gjatë takimit me studentët e programit, ata shprehën një vlerësim pozitiv për lehtësinë e marrjes së informacionit. Takimi me studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion			
Konkluzione	UNIKO ofron forma dhe metoda të ndryshme për informimin lidhur me organizimin dhe funksionimin e programit të studimeve. Studentët e këtij programi kanë akses në informacion përmes kanaleve elektronike dhe janë të integruar në një platformë të posaçme për informim të brendshëm			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UNIKO disponon evidenca dhe statistika, të përditësuara çdo vit, që përfshijnë të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar për çdo vit akademik për këtë program studimi. Vizita e GVJ në institucion Shtojca II.21 Raportet e vjetore të veprimtarisë mësimore të Departamentit të Edukimit Shtojca II.26 Raportet vjetore të veprimtarisë mësimore të FEF Shtojca II.25 Raportet e vlerësimit të NJSBC
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe	UNIKO dhe FEF disponojnë dokumentacion të plotë periodik në lidhje me statistikat vjetore të studentëve të regjistruar, të tërhequr nga programi, të larguar para përfundimit të programit apo të studentëve, që nuk përfundojnë me sukses vitin akademik. Kjo tendencë është e pranishme edhe në numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në program. Sekretaria mësimore ruan dhe përditëson të dhënat e çdo studenti dhe

largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	statistikat e përgjithshme për këtë program, në regjistra të veçantë sipas formatit të miratuar nga Ministria e Arsimit. Numri i studentëve për tre vitet akademike janë si më poshtë: 2022-2023 41 studentë 2023-2024 37 studentë 2024-2025 39 studentë <i>Vizita e GVJ në institucion</i> Shtojca II.21 Raportet e vjetore të veprimtarisë mësimore të Departamentit të Edukimit Shtojca II.26 Raportet vjetore të veprimtarisë mësimore të FEF Shtojca II.25 Raportet e vlerësimit të NJSBC
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të universitetit, që përfshin regjistra të printuar dhe dokumente elektronike. Këto të dhëna janë lehtësisht të kontrollueshme dhe të verifikueshme nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ verifikoi regjistrimet e studentëve në regjistrin themeltar. Institucioni përdor sistemin Pitagora, në bazë të marrëveshjes me RASH dhe të dhënat mblidhen nga dokumentet bazë, procesverbalet dhe dokumentet e tjera të përgatitura dhe plotësuar sipas akteve dhe rregulloreve të UNIKO. <i>Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara nga sekretaria mësimore i nënshtrohen kontrolleve periodike nga strukturat e tjera eprore dhe përdoren në analizat akademike të Departamentit të Edukimit si njësi bazë dhe FEF si njësi kryesore. Këto të dhëna gjithashtu kryqëzohen me informacionin e përpunuar nga sistemet e brendshme të menaxhimit dhe përpunimit të universitetit. <i>Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi	Gjatë vizitës së realizuar nga GVJ në institucion, u evidentua bashkëpunimi ndërmjet Departamentit të Edukimit dhe zyrës Alumni të universitetit për shkëmbimin dhe analizën e të

profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	dhënave të studentëve të regjistruar. Në analizën e përgatitur nga departamenti përfshiheshin të dhëna mbi hyrjen dhe daljen e numrit të studentëve, por mungonin informacione mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve në programin Bachelor për “Edukim Fizik dhe Sporte”. Shtojca II.21 Raportet e vjetore të veprimtarisë mësimore të Departamentit të Edukimit Shtojca II.26 Raportet vjetore të veprimtarisë mësimore të FEF Shtojca II.25 Raportet e vlerësimit të NJSBC			
Konkluzione	UNIKO menaxhon dhe përditëson statistikën e studentëve përmes sistemeve të brendshme, përfshirë Pitagora dhe regjistrat e miratuar nga Ministria e Arsimit. Të dhënat tregojnë qëndrueshmëri në regjistrimet në programin Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Bazuar edhe në kriterin 5 vlen për tu theksuar se bashkëpunimi ndërmjet Departamentit të Edukimit dhe zyrës Alumni ndihmon në analizën e të dhënave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në përputhje me ligjin 80/2015 dhe statutet dhe rregulloret e tij, UNIKO garanton përfaqësimin e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese në nivel institucional, si në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe NJSBC. Sipas rregullores së UNIKO, operon gjithashtu Këshilli Studentor, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve. U evidentua pjesëmarrja e studentëve në këto organe vendimmarrëse, si dhe angazhimi i tyre në takimet e zhvilluara nga këto struktura përmes vendimeve të miratuara për ngritjen dhe funksionimin e tyre. Shtojca I.1 Statuti i UNIKO Shtojca I.26 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore- kërkimore shkencore FEF
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se	Nga shqyrtimi i dosjes së aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it dhe nga takimi me studentët gjatë vizitës së GVJ në

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	institucion, u evidentua roli aktiv i studentëve dhe i përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse. Po ashtu, studentët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin periodik të nivelit të mësimdhënies, proces që realizohet përmes anketave anonime dhe diskutimeve direkte me titullarët e lëndëve përkatëse të programit. Përveç kësaj, në RVB të programit, një nga anëtarët e grupit është student. <i>Takime me studentë gjatë vizitës në institucion të GVJ</i> <i>Shtojca I.17 Rregulloren e Këshillit Studentor</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit bëhet kryesisht përmes vlerësimeve të tyre, të cilat mbledhen nëpërmjet anketave për programin dhe për pedagogun e lëndës, të organizuara nga NJSBC. Po ashtu, ky vlerësim përforcohet nga diskutimet që studentët zhvillojnë me pedagogët e lëndëve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit dhe verifikimi gjatë vizitës në institucion, <i>GVJ nuk ka evidentuar ndryshime në kurrikulën e programit të studimit që nga fillimi i tij.</i> <i>Takime me studentë gjatë vizitës në institucion të GVJ</i> <i>Shtojca I.17 Rregulloren e Këshillit Studentor</i> <i>Shtojca I.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për autoritet dhe organet drejtuese UNIKO</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në kuadrin rregullator të institucionit dhe në takimin e GVJ me studentët e programit, u vërejt se studentët kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre për përmirësimin e programit dhe gëzojnë të drejtën e ankimimit lidhur me procesin e vlerësimit. Gjithashtu, nga takimi me stafin akademik që zhvillon këtë program, u konfirmua se studentët kanë mundësi të shprehin ankesat e tyre dhe angazhimin për gjetjen e zgjidhjeve. <i>Takime me studentë gjatë vizitës në institucion të GVJ</i> <i>Shtojca III.1 Pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi</i>
Konkluzione	<i>Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese të universitetit dhe prania e tyre në këto struktura është e garantuar institucionalisht. Megjithatë, ata rrallëherë shprehin shqetësime apo sugjerime për përmirësimin e programeve. Studentëve u ofrohen të gjitha mundësitë e nevojshme për të rishikuar vlerësimet e tyre në rast se konsiderojnë se rezultatet e arritura nuk përputhen me pritshmëritë e tyre. Pedagogët janë të gatshëm dhe të detyruar të ofrojnë sqarime përmes seancave të posaçme kur është e nevojshme.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Përveç Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingun, UNIKO ofron informim dhe mbështetje për studentët kryesisht përmes zyrave të dedikuara për pritjen, informimin dhe këshillimin e tyre: Zyra e Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës. Nga takimet e GVJ-së me anëtarët e këtyre zyrave dhe studentët, u konstatua se këto zyra funksionojnë në shërbim të studentëve, në përputhje me aktet rregullatore të UNIKO-së. <i>Takimet gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Informimi i studentëve për programin e studimit realizohet që nga procesi i regjistrimit, gjatë zhvillimit të programit dhe deri në përfundimin e diplomimit, kryesisht përmes Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Studentëve dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Studentët mund të marrin informacion mbi ecurinë e vlerësimit të procesit mësimor edhe nga anëtarët e stafit akademik që mbulojnë këtë program dhe nga njësia bazë e institucionit. Në fillim të çdo viti akademik, FEF, si njësi kryesore e programit, organizon javën e orientimit për studentët, ku ata marrin informacion të detajuar mbi procesin mësimor, platformat e përdorura, mënyrat e vlerësimit, modelin e një programi lënde etj. <i>Takime me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor,	Zyra e Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës ndjekin të gjithë procesin e informimit për studentët dhe bashkëpunojnë me struktura të tjera të institucionit për të siguruar një informim sa më të plotë. Këto zyra mbajnë gjithashtu lidhje me tregun e punës, duke orientuar studentët për mundësi praktike dhe punësimi. <i>Takime me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës monitoron vazhdimisht punësimin e studentëve gjatë periudhës së studimeve si edhe pas diplomimit. Çdo vit akademik, kjo zyrë harton një raport analitik, duke përditësuar të dhënat mbi punësimin e tyre për çdo nivel programi. <i>Takime me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>			
Konkluzione	<i>UNIKO ka zyra të dedikuara që ndjekin progresin dhe ecurinë e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Sekretaria Mësimore, Zyra e Studentëve dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës janë kanalet kryesore për informimin e studentëve, si para, gjatë, ashtu edhe pas diplomimit. Nga këndvështrimi institucional, progresi akademik dhe zhvillimi i karrierës së studentëve monitorohet nga këto zyra.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit, RVB dhe në takimin me stafin akademik të programit dhe studentët e tij, GVIJ konstatoi se UNIKO ka struktura dhe procedura të mirë përcaktuara për SBC në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. UNIKO ka ngritur

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	NJSBC-në në nivel institucional e cila funksionon në përputhje me rregulloren e NJSBC-së së UNIKO. Institucioni ka hartuar udhëzuesin strategjik të metodave innovative të mësimdhënies. Gjithashtu janë organizuar edhe trajnime në nivel institucional për procesin e mësimdhënies ku në të ka pasur edhe anëtarë të stafit të Departamentit të Edukimit. Ndihmë në këtë drejtim është edhe hartimi nga institucioni i Planit Strategjik të Ndërkombëtarizimit. Institucioni ka të plotë kuadrin rregullativ të SBC si atë të Politikave dhe procedurave të UNIKO që kanë fokus të tyre rritjen e cilësisë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	NJSBC është pjesë e strukturës së UNIKO me përfaqësues një koordinator nga çdo njësi kryesore. Pranë FEF organizohet dhe funksionon Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Studimit, mbështetur në Rregulloren e FEF. Kjo njësi e bazon veprimtarinë e saj në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe gjithashtu: - harton politika dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë; - vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore duke hartuar raporte të vlerësimit nga studentët të procesit mësimor si dhe të vlerësimit të performancës së personelit akademik; - realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë; - harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë; - prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së UNIKO-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në UNIKO. Njësia bazë vlerëson dhe miraton raportet mbi monitorimin e aftësive të mësimdhënies dhe inovative të personelit akademik. <i>Shtojca I.3 Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Shtojca I.1 - Statuti i UNIKO, Kreu IX, Neni 84, Pika (1)</i> <i>Shtojca I.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e	Kuadri rregullator i UNIKO u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të përpara zhvillimit të provimit të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj, përmes zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS), organizuar nga ASCAL. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit dhe verifikimin e GVJ, në takimet me

trajtimin të ankimimeve.	stafin akademik të programit dhe studentët, evidentohet përfshirja e studentëve në mënyrë periodike në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe gjithashtu të vlerësimit prej tyre të metodave të përdorura gjatë zhvillimit të programit. Në UNIKO njësitë kryesore kanë përfaqësuesin e tyre pranë NJSBC. <i>Shtojca III.1 Pyetësi studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi</i>		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra NJSBC referuar dhe rregullores së saj, raporton mbi vlerësimet e mbledhura së pari tek personeli akademik dhe strukturave vendimmarrëse të fakultetit. Këto raporte janë pjesë e diskutimeve brenda departamentit duke reflektuar gjithnjë drejt përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentet</i> <i>Shtojca III.1 Pyetësi studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi</i>		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e dokumentacionit dhe nga vizita në institucion në takimet me stafin akademik dhe studentët e programit, GVJ konstatoi analizën e raporteve të vlerësimeve të personelit në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë duke u bërë pjesë e mbledhjeve në departament nëpërmjet diskutimeve konstruktive, të cilat promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm.		
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësit përmes zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS), organizuar nga ASCAL, Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni. NJSBC si strukturë e posaçme e sigurimit të cilësisë e cila operon në nivel institucional harton periodikisht raportet e saj vjetore të monitorimit dhe vlerësimit të mësimdhënies në institucion</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it , RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se, në planin strategjik të zhvillimit të UNIKO, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit dhe planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjor. Në UNIKO në nivel institucional monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie funksionon NJBSC si hallka kryesore e këtij procesi e cila në bashkëpunim me njësitë kryesore realizon mision e saj të përcaktuar në rregulloren përkatëse në funksion të misionit dhe vizionit të UNIKO. <i>Shtojca I.3 Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Shtojca I.1 - Statuti i UNIKO, Kreu IX, Neni 84, Pika (1)</i> <i>Shtojca I.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca I.1 Statuti UNIKO Kreu IX</i> <i>Shtojca I.16 Manualin e Cilësisë UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentet</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se, në UNIKO është ngritur dhe operon NJSBC në nivel institucional bazuar në Statutin e UNIKO. Në mbështetje të kësaj njësie janë politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe një sërë aktesh rregullative të institucionit si, Manuali i brendshëm i Cilësisë, Rregullorja e funksionimit të NJSBC, Procedurat e institucionit për sigurimin e cilësisë etj. <i>Shtojca I.1 - Statuti i UNIKO, Kreu IX, Neni 84, Pika (1)</i> <i>Shtojca I.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca I.1 Statuti UNIKO Kreu IX</i> <i>Shtojca I.16 Manualin e Cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca I.16 Rregulloren e DKVI, Kreu V, Neni 13, Pika (3)</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë.	GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UNIKO realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Konkretisht, UNIKO është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të

Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Akreditimit Nr. 02, datë 27.01.2023 duke plotësuar standardet institucionale. Ndërsa për programin e studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" ky është akreditimi i parë. <i>Shtojca VI.2 Për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UNIKO dhe FEF paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjëseve të departamentit, si dhe dekanëve përkatës. Gjithashtu NJSBC realizon edhe vlerësimin e performances së stafit akademik bazuar në kriteret e përcaktuara duke hartuar dhe raportin vjetor përkatës. <i>Shtojca I.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca I.1 Statutit të UNIKO, Kreu IX, Neni 85, Pika 10,</i> <i>Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Edukimit</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se në UNIKO procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ndërkohë, UNIKO ka marrë akreditimin institucional në vitin 2023. Program i studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte" është për herë të parë në proces akreditimi. <i>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe analizat e ecursisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstatoi nga RVB dhe dokumentacioni i aplikimit pranë ASCAL it, se në Fakultetin e Edukimit, përdoren metoda të ndryshme si, kontrollet nga drejtuesit e Njesisë Kryesore, analizat dhe diskutimet në mbledhje të departamentit dhe fakultetit, anketimet e studentëve. Lektorët çdo vit dorëzojnë të drejtuesi i njesisë formularët e raporteve të veprimtarisë së tyre kërkimore shkencore. UNIKO përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregulloreve të studimit. Raportet e analizës mësimore shkencore të Departamentit të FEF që mbulon këtë program pas analizës në këtë njësi janë pjesë e raporteve të njesisë kryesore FEF dhe të institucionit. <i>GVJ gjate vizitës në Institucion</i> <i>Shtojcën III.1 Pyetësor fund kursi</i> <i>Shtojca I.16 – Manuali i cilësisë UNIKO, Shtojca 2.</i> <i>Shtojca I.26 Rregulloren e Brendshme të FEF, Kreu II, Neni 7</i> <i>Në dosjen e pedagogut, çdo pedagog ka të depozituar relacionet me shkrim të hartuara në përfundim të lëndëve/moduleve që ai mbulon.</i> <i>Shtojca VI.3 Programi i veprimtarive për mirëvijimin e vitit akademik</i> <i>Shtojca I.26 Rregulloren e Brendshme FEF, Kreu V, Neni 63</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi nga RVB se në nivel institucional, NJSBC realizon çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UNIKO-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Ky raport përmbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. Megjithatë raportet si të NJSBC, FE apo Departamentit të FEF janë të plota me tabela statistikore por të paplota me analizën e tyre. GVJ gjatë vizitës konstatoi se në raportet e vlerësimit nga studentët për stafin akademik si dhe vlerësimit të performancës të këtij stafi ishin të detajuara. <i>GVJ gjate vizitës në Institucion</i> <i>Shtojca III.1 Pyetësorë studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi</i> <i>Shtojcën II.25 Raportet e vlerësimit të NJSBC</i>



	<i>Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë së departamentit</i> <i>Shtojca I.16 – Manuali i cilësisë UNIKO, Shtojca 3</i> <i>Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë të Departamentit të Edukimit</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i aplikimit pranë ASCAL dhe RVB-së në nivel institucional është hartuar nga NJSBC dhe është miratuar paketa e instrumenteve matës të cilësisë në UNIKO. Në fund të vitit bëhet vlerësimi i pedagogëve duke u mbështetur në këtë paketë të vlerësimit të performancës. Përpos iniciativës së përmendur, metoda e drejtpërdrejtë e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies është pyetësori i studentëve në fund të çdo semestri. Analiza e raporteve të pyetësorëve diskutohen në mbledhjet e departamentit. Gjithashtu lektorët në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme dorëzojnë në departament CV-të e rifreskuara. NJSBC monitoron dhe vlerëson edhe elementet e ngarkesës mësimore në auditor, rezultatet e studentëve në testet e vitit dhe atë final, ndjekjen e praktikës etj. <i>Shtojcën II.25 Raportet e vlerësimit të NJSBC</i> <i>Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë të Departamentit të Edukimit.</i> <i>GVJ gjatë vizitës në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për	Bazuar në informacionin e aplikimit pranë ASCAL dhe RVB, ne konstatuam se UNIKO përdor metoda indirekte të vlerësimit lidhur me matjen e cilësisë, ku bëjnë pjesë: Pyetësorë për studentët mbi lëndën dhe pedagogun që e zhvillon atë, formularin e performancës së pedagogut dhe veprimtarinë e tij, vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu; GVJ vlerëson këto metoda të përdorura të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. <i>GVJ gjatë vizitës në Institucion</i> <i>Shtojca III.1 Pyetësorë studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi</i> <i>Shtojcën II.25 Raportet e vlerësimit të NJSBC</i> <i>Shtojca I.16 Manuali i Cilësisë UNIKO, "Roli i aktorëve në UNIKO për vlerësimin e cilësisë"</i>

vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitorimin dhe vlerësimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni NJSBC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësorë dhe sasiore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. UNIKO përmirëson në vazhdimësi kuadrin rregullator mbi metoda të reja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. GVJ konstatoi se në raportet e vlerësimit nga studentët për stafin akademik si dhe vlerësimit të performancës të këtij stafi tishin të detajuara duke përfshirë analiza më të plota të tabelave statistikore me qëllim të evidentimit të mangësive të mundshme të dalë nga ky proces.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacion e aplikimit pranë ASCAL dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UNIKO, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në Manualin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Shtojca I.16 Manuali i Cilësisë UNIKO, "Roli i aktorëve në UNIKO për vlerësimin e cilësisë"
Kriteri 2. Institucioni	Në Manualin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në UNIKO, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UNIKO <i>Shtojcën II.25 Raportet e vlerësimit të NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ vlerëson se UNIKO garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. NJSBC përbëhet nga anëtarë nga personeli akademik, përfaqësues të njësive kryesore dhe studentët përkatës të këtyre njësive. Edhe në hartimin e RVB krahas anëtarëve staf akademik të programit studentët dhe personeli ndihmës akademik janë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në nivel institucional është ngritur Njësia e Sigurimi të Brendshëm të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik student për çdo njësi kryesore si dhe ekspert i jashtëm të cilët kanë integritetin e duhur akademik duke shmangur kështu çdo lloj diskriminimi apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UNIKO angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Siç edhe e kemi theksuar më lartë në përbërjen e NJSBC ka ekspertë të jashtëm që njohin fushën e Edikimi Fizik dhe Sporteve. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UNIKO dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.

	GVJ gjatë vizitës në Institucion			
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përmes aktiviteteve si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UNIKO realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, dokumentacionin përkatës të aplikimit si dhe të takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO parashikon publikimin e politikave, strategjive, raporteve të ndryshme dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. UNIKO përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email, dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi si dhe guida e institucionit . <i>Evidentim nga GVJ të publikimeve dhe informacionit që UNIKO jep në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimet në faqen zyrtare web të UNIKO dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare web të UNIKO dhe komunikimeve në platformën Pitagora. <i>Evidentim nga GVJ të publikimeve dhe informacionit që UNIKO jep në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale</i>
Kriteri 3. Rezultatet e	GVJ konstatoi se pas vlerësimit të personelit akademik,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	raportet përcillen nga NJSBC në njësinë bazë të programit FEF dhe Departamenti i Edukimit. Raportet pasi u bëhen me dije personelit, diskutohen duke ndarë praktikat e mira dhe duke marrë masa për përmirësim të vazhdueshëm mbi problematikat e evidentuara. <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i> <i>Shtojca II.21 Raportet vjetore të veprimtarisë të Departamentit të Edukimit</i> <i>Shtojca VI.3 Programi i veprimtarive për mirëvijimin e vitit akademik</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UNIKO realizohen periodikisht analiza në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi aktivitet e organizuar në nivel fakulteti dhe departamenti në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme. Aktivitetet si Panairi i Punës, takime të hapura etj. të publikuara dhe në faqen zyrtare të UNIKO apo rrjete sociale kanë objektiv kryesorë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë të personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës. <i>Vizita në Institucion GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentët.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se UNIKO publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. Institucioni angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Përvoja dhe suksesi i udhëheqjes menaxheriale dhe akademike institucionale ndikon në avancimin e procesit të të nxëniet dhe në arritjen e objektivave të mësimdhënies e të nxëniet të programit të studimit.
2. Marrëdhëniet bashkëpunuese me institucionet publike dhe private të lidhura me programin e studimit, rrisin cilësinë e praktikave profesionale të studentëve.
3. Programi përfshin një gamë të gjerë disiplinash që rrisin informacionin mbi aktivitetin fizik për shëndet, edukimit fizik dhe sportet, si dhe institucioni zotëron aftësitë e kapacitetet për të siguruar mundësi për studime të avancuara në ciklin e dytë brenda këtyre fushave.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok me institucionet akademike ndërkombëtare pengon lëvizjen e personelit akademik dhe studentëve në kuadër të programeve Erasmus+, duke penguar kështu proceset e ndërkombëtarizimit dhe iniciativat bashkëpunuese universitare (Standardi I.2, Kriteri 3).
2. Programi i studimit duhet të mbështetet nga investime të konsiderueshme të brendshme në ambiente, mjedise, pajisje sportive moderne me standarde olimpike, literaturë të përditësuar për bibliotekën dhe sidomos laboratorë për vlerësimin e cilësive fizike ose parametrave thelbësorë për zbatimin efektiv të programit. (Standardi I.2, Kriteri 2).
3. Stafi akademik që nuk ka trajnimin e mjaftueshëm të përgjithshëm dhe të specializuar (të dokumentuar) për të dhënë mësim lëndë/module të caktuara, zvogëlon cilësinë e mësimdhënies dhe përvetësimin e njohurive, duke bërë kështu të domosdoshme kualifikimin dhe rikualifikimin e tyre në përputhje me ngarkesën vjetore akademike të caktuar (Standardi III.1, Kriteri 4).



Rekomandime:

1. Investimet në laboratorët specifike të performancës fizike në UNIKO duhet të jenë prioritetet e së ardhmes për të garantuar një program studimi i cili mbështetet nga investime serioze në funksion të rritjes së cilësisë së formimit profesional të studentëve të cilët shojnë të përgatitur në ciklin e dytë të studimit.
2. FEF dhe DE në UNIKO duhet të rishikojnë shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas lëndëve dhe moduleve duke u kujdesur në përputhjen e profilizimit të përgjithshëm dhe të thelluar të stafit akademik i cili duhet të ketë kompetencën e duhur për të marrë përsipër lëndën apo modulën sidomos ato me karakter sportiv.
3. Mbetet shumë i rëndësishëm kualifikimi i stafit akademik MSc, (fillimi i Ciklit të tretë të studimit) të cilët duhet të jenë më aktivë në studime shkencore, referime apo botime si brënda ashtu edhe jashtë vendit si një detyrim vjetor akademik në IAL-të e Republikës së Shqipërisë.

Conclusions of the Evaluation of the Initial Cycle Bachelor's Degree Program in "Physical Education and Sports", "Fan S. Noli" University, Korçë

Strengths and affirmations:

1. The efficacy and accomplishments of institutional administrative and academic leadership impact the progression of the learning process and the attainment of the educational objectives of the study program.
2. Collaborative partnerships with public and commercial institutions associated with the study program enhance the quality of the students' professional practices.
3. The curriculum encompasses a diverse array of subjects that enhance knowledge regarding physical activity for health, physical education, and sports, and the school is equipped to offer chances for advanced study at the postgraduate level within these domains.

Weak points:

1. The absence of reciprocal cooperation agreements with international academic institutions impedes the mobility of academic personnel and students under the Erasmus+ program, thereby obstructing internationalization efforts and collaborative university initiatives (Standard I.2, Criterion 3).



2. The academic program must be bolstered by substantial internal investments in facilities and environments, modern Olympic-standard sports equipment, current literature for the library, and particularly laboratories for evaluating physical qualities or parameters crucial to the program's effective execution. (Standard I.2, Criterion 2).
3. Academic personnel lacking adequate general and specialized documented training to instruct specific subjects/modules diminish the quality of education and knowledge acquisition, necessitating their qualification and re-qualification in alignment with the annual academic workload (Standard 3.1, Criterion 4).

Recommendations:

1. Prioritizing investments in specialized physical performance laboratories at UNIKO is essential to ensuring a study program bolstered by substantial funding and, hence, enhancing the quality of professional training for students entering the second cycle of study.
2. FEF and DE at UNIKO must evaluate the allocation of teaching responsibilities by subjects and modules, ensuring alignment with the general and specialized qualifications of the academic personnel, particularly for those pertaining to sports-related content.
3. The qualifications of the MSc academic staff at the commencement of the third cycle of study are crucial; they should engage more actively in scientific research, references, or publications both nationally and internationally as an annual academic duty in the higher education institutions of the Republic of Albania.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



